



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Kuvendi i Komunës së Prizrenit

Nr. 001/011-73507

Më: 04 qershor 2024

Prizren

Në bazë të nenit 11, nenit 12.2, shkronja c), neni 17 shkronja f) dhe p), nenit 40 paragrafi 40.2, shkronja (a). të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 25, paragrafit 1 shkronja a), nenit 27, nenit 50. paragrafi 1. shkronja (l) të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, më 15 tetor 2008, Kuvendi Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 04 qershor 2024, miratoi

RREGULLORE PËR SHËRBIME PUBLIKE KOMUNALE NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Prizren 2024

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Në bazë të kësaj Rregulloreje përcaktohen të drejtat dhe detyrat e qytetarëve, kushtet minimale për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës në territorin e komunës, të këshillave shtëpiakë, të vendbanimeve, të ndërmarrjeve, të enteve, të institucioneve, të organeve të administratës, të organizatave politike, të organizatave joqeveritare dhe të subjekteve të tjera, llojet e objekteve të përkohshme (në tekstin në vazhdim *objekti i përkohshëm*), kushtet dhe procedurat për vendosjen dhe largimin e objekteve në pronën publike, në të cilën Komuna e ka të drejtën e udhëheqjes.

Neni 2

Shërbimet komunale, në vështrim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

- furnizimi me ujë;
- përcjellja, përpunimi dhe pastrimi i ujërave të zeza dhe atmosferike;
- rregullimi dhe mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbra publike;
- pastrimi i sipërfaqeve publike në vendbanime;
- bartja, deponimi dhe përpunimi i mbeturinave;
- mirëmbajtja dhe rregullimi i sipërfaqeve publike;
- mirëmbajtja e ndriçimit publik;
- mirëmbajtja e varrezave;
- rregullimi dhe mirëmbajtja e objekteve sportive (të hapura);

Neni 3

Objekte komunale – publike, në vështrim të kësaj Rregulloreje, konsiderohen:

- rrjeti i tërësishëm i ujësjellësit dhe kanalizimit, me të gjitha pajisjet;
- rrugët dhe trotualet;
- sheshet;
- hapësirat për parking;
- sipërfaqet publike të gjelbra;
- terrenet sportive;
- varrezat;
- pajisjet për ndriçim publik;
- rrjeti i PTK - së dhe telefonat publikë;
- nyjat sanitare publike;
- tabelat për shpallje;
- panotë ndriçuese, reklamat dhe
- të gjitha objektet tjera, të cilat, sipas destinimit që kanë, mund të konsiderohen objekte komunale.

Neni 4

Vendosja dhe largimi i objekteve të përkohshme në hapsira publike – me këtë Rregullore përcaktohet baza juridike dhe kriteret themelore për lejimin e vendosjes dhe largimin e objekteve të përkohshme në sipërfaqe publike, llojet e objekteve, mënyra e vendosjes së tyre, si dhe kriteret për përcaktimin e tarifës.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Ujësjiellësi dhe kanalizimi

Neni 5

5.1 Ndërmarrjet, detyrë e të cilave është furnizimi i rregullt i qytetarëve me ujë të pijshëm, përpunimi, pastrimi dhe përcjellja e ujërave të zeza dhe atmosferike, bëjnë shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve të parapara sipas nenit 3 të kësaj Rregulloreje, gjegjësisht:

- bëjnë mirëmbajtjen dhe sigurimin e rregullt të të gjitha objekteve, pajisjeve dhe instalimeve të ujësjiellësit dhe të kanalizimit;
- bëjnë kontrollimin e përhershëm të cilësisë së ujit të pijshëm, sigurimin e përhershëm të rregullsisë higjienik - teknike të ujit të pijes, sipas dispozitave ligjore për këtë lëmë;
- bëjnë ndërtimin dhe rikonstruktimin e objekteve, pajisjeve dhe instalimeve të ujësjiellësit dhe kanalizimit;
- japin kushtet për sigurimin e lidhjeve në rrjetin e ujësjiellësit dhe të kanalizimit dhe
- bëjnë pastrimin e të gjitha pusetave akumuluese dhe të pusetave për ujërat atmosferike dhe ujërave të zeza, së paku një herë në vit - ndërmarrja e autorizuar në bashkëpunim me komunën.
- Ndërmarrja, nga pika 1 e këtij neni, të gjitha objektet dhe instalimet e ujit dhe të kanalizimit, i mirëmban në pajtim me këtë rregullore dhe është e detyruar që t'i mbajë si mjete të veta themelore në shfrytëzim, përveç atyre objekteve për ndërtimin e të cilave investon Komuna dhe të cilat objekte- mjete me marrëveshje të veçante Komuna mund t'i jep në menaxhim dhe shfrytëzim ndërmarrjes publike.
-

Neni 6

- 6.1 Mbikëqyrjen e cilësisë së ujit e bën organi kompetent sanitar, sipas dispozitave ligjore, propozon masat nga kompetencat e veta dhe i ndërmerr masat me të cilat sigurohet cilësia e kërkuar.
- 6.2 Vlerësimin për cilësinë e ujit e jep laborator i ndërmarrjes publike, së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjiellësit dhe të kanalizimit dhe i vërteton Enti i autorizuar shëndetësor;
- 6.3 Ndërmarrja që është përgjegjëse për furnizimin me ujë, është e obliguar që teste të tilla të ketë edhe sipas kërkesës së këshillave të banimit, në rastet kur ka dyshim për cilësinë e ujit.

Neni 7

Të gjithë shfrytëzuesit e ujit të pijshëm nga kaptazhet (*kaptazh* – prurja e ujit nga një vend me anë të sistemit të gypave) më të vogla të pompave shpërndarëse në vendbanimet ku ekziston rrjeti qendror i ujësjiellësit, janë të detyruar të kyçen në këtë rrjet në afat prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 8

- 8.1 Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, është e obliguar që shfrytëzuesve t'u sigurojë rregullisht ujë të pijshëm.
- 8.2 Obligimet nga paragrafi paraprak pushojnë të vlejnë në rast:
 - 8.2.1 të veprimit të fuqisë madhore;
 - 8.2.2 të pengesave të jashtëzakonshme teknike, të bëra pa fajin e ndërmarrjes nga paragrafi paraprak;
 - 8.2.3 të punëve të rregullta ose të jashtëzakonshme për përmirësimin e nyjeve të ujësjellësit dhe kanalizimit;
 - 8.2.4 të kryerjes së punëve të reja ose rikonstruktimit të pajisjeve të ujësjellësit dhe kanalizimit
 - 8.2.5 Për të gjitha këto raste të furnizimit jo të rregullt me ujë, ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e obliguar që, përmes mjeteve të informimit publik, t'i njoftojë shfrytëzuesit mbi shkaqet dhe periudhën kohore të ndërprerjes së furnizimit me ujë.
- 8.3 Me rastin e ndërprerjeve lokale të furnizimit me ujë, të planifikuara më parë, shfrytëzuesit, së paku 24 orë më parë, duhet të njoftohen për datën dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes

Neni 9

- 9.1 Çdo objekt i cili furnizohet me ujë nga ujësjellësi publik i qytetit, patjetër duhet ta ketë lidhjen e veçantë të ujësjellësit.
- 9.2 Objektet nga paragrafi paraprak, duhet të kenë rrjetin e veçantë të kanalizimit.
- 9.3 Me rastin e ndërtimit të rrjetit të ri të ujësjellësit dhe të kanalizimit, dhe rikonstruktimit të rrjetit ekzistues, investitori është i obliguar që, përveç linjës kryesore të ujësjellësit, t'i kryejë edhe lidhjet deri te linja e rregullacionit në bazë të planit urbanistik. Këto punë duhet t'i kryejë ndërmarrja e autorizuar për këtë qëllim.

Neni 10

- 10.1 Ndërtimin e rrjetit të ri nëpër rrugë në të cilat ekzistojnë përcjellësit kryesorë të ujësjellësit dhe të kanalizimit, me kërkesën e investuesit, kryesisht i kryen ndërmarrja së cilës i janë besuar punët për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, ose në mbikëqyrje të saj.
- 10.2 Ndërmarrja nga pika paraprake, obligohet që gjatë ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, t'u përmbahet dispozitave sanitare-teknike për vendosjen e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit. Ndërmarrja nga pika 10.1 e këtij neni, është përgjegjëse për cilësinë e të gjitha punëve rreth lidhjes me rrjetin gjegjës.

Neni 11

- 11.1 Instalimet e ujësjellësit dhe të kanalizimit lidhen në ujësjellës dhe kanalizim, me anë të pajisjeve të rrjetit. Vendosja e nyjeve përcjellëse, nënkupton bashkimin e rrjetit publik të ujësjellësit deri te ujëmatësi, respektivisht prej rrjetit rrugor deri te linja e rregullacionit.
- 11.2 Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit, do ta mirëmbajë rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, bashkë me nyjet përcjellëse të ujëmatësit, deri te objekti i parë akumulues i pusëtës.
- 11.3 Ndërmarrja nga paragrafi paraprak, është e obliguar që ta mirëmbajë edhe ventilin e pare të ujëmatësit.

Neni 12

- 12.1 Çdo objekt i cili kufizohet me rrugët ose sheshin ku është ngritur rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit, duhet të jetë i kyçur në rrjetin e ujësjellësit e të kanalizimit përmes nyjave përcjellëse.
- 12.2 Pronarët që kanë hidroforë dhe ata të cilët furnizohen me ujë në mënyrë jo adekuate, si dhe pronarët e nyjeve sanitare me gropa septike, janë të obliguar që të bëjnë kyçjen menjëherë në nyjat e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, gjegjësisht, më së voni, në afatin prej dy muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 13

- 13.1 Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, i jep shënimet për punimin e dokumentacionit teknik të instalimit të ujit dhe të kanalizimit, si dhe të nyjave përcjellëse.
- 13.2 Nyjat përcjellëse mund të ngrihen në bazë të lejes për ndërtim.
- 13.3 Leja nga paragrafi paraprak, lëshohet në bazë të dokumentacionit teknik për objektet e ndërtuara.

Neni 14

- 14.1 Pëlqimin për nyjën përcjellëse në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, e jep ndërmarrja së cilës i janë besuar punët.
- 14.2 Lejen për rrëmihjen e rrugëve, trotuareve dhe të sipërfaqeve publike për vënien e nyjave në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, e jep organi kompetent – Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor (DUPH).

Neni 15

- 15.1 Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, është e obliguar që ta bëjë lidhjen e ujësjellësit dhe kanalizimit rrugor me pajisjet shtëpiake të ujësjellësit dhe të kanalizimit, nëse këto janë kryer me projektin e lejuar dhe sipas dispozitave dhe kushteve teknike, në afat prej 15 ditësh nga dita e njoftimit se janë kryer punët përgatitore për lidhje.
- 15.2 Nëse ndërmarrja nga pika paraprake, nuk e kryen lidhjen me kërkesën e palës, atëherë organi kompetent komunal, këto punë mund t'ia besojë personit tjetër juridik ose fizik të autorizuar për kryerjen e këtyre punëve.

Neni 16

Shpenzimet e lidhjes në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit, i bartin shfrytëzuesit e rrjetit të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Neni 17

Ndalohet lidhja pa leje në rrjetin publik të ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Neni 18

Matja e ujit të shpenzuar nga rrjeti publik i ujësjellësit, duhet të kryhet vetëm përmes ujëmatësit. Në rast të prishjes së ujëmatësit, ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së tyre, do të caktojë shumën e paragjykuar (paushall), sipas Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit deri të kthehet ujëmatësi i rregulluar (ose i ri).

Neni 19

- 19.1 Pronarët e objekteve me rrjet të ujësjellësit, ku shpenzimet e ujit paguhen në mënyrë të paragjykuar, janë të obliguar që në afatin prej 60 ditësh nga dita e hyrjes së kësaj Rregulloreje në fuqi, me shpenzimet e veta, ta vendosin ujëmatësin në rrjetin e vet.
- 19.2 Nëse shfrytëzuesi i ri nuk e vendos ujëmatësin, ndërmarrja e autorizuar menjëherë do ta shkyç shfrytëzuesin e ri nga ujësjellësi publik dhe do të kërkojë dëmshpërblim.

Neni 20

- 20.1 Vendosjen, respektivisht montimin e ujëmatësve dhe ndërrimin e ujëmatësve të vjetër, e bën ekskluzivisht ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, dhe atë në afat prej 20 ditësh nga dita e paraqitjes nga ana e pronarit.
- 20.2 Vendosja e ujëmatësve të rinj dhe riparimi dhe ndërrimi i ujëmatësve të vjetër, bëhet me shpenzimet e shfrytëzuesve të ujëmatësve.

Neni 21

Ujëmatësit patjetër duhet të jenë të mbrojtur dhe të vendosur në vendet e veçanta dhe të mbyllura, të cilat ndërtohen me shpenzimet e investuesit, respektivisht të pronarit të objektit, në bazë të udhëzimeve të ndërmarrjes së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Neni 22

Çdo prishje dhe dëmtim të ujëmatësit, konsumatori është i obliguar që menjëherë ta paraqesë te ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, dhe kjo është e obliguar që këtë prishje dhe dëmtim ta sanojë në afatin prej 24 orësh.

Neni 23

Shpenzimet e mirëmbajtjes së kyçësve në rrjetin e ujësjellësit, prej lidhjes me rrjetin e jashtëm të ujësjellësit deri te ujëmatësi, i mbulon ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, të tjerat i mbulon konsumatori.

Neni 24

Konsumatorët dhe shfrytëzuesit e rrjetit të ujësjellësit publik, janë të obliguar që të ndërmarrin masa me kohë, në mënyrë që instalimet brenda shtëpive të mbrohen nga prishjet, ngricat dhe të mbahen në gjendje të rregullt.

Neni 25

Riparimin e ujëmatësit mund ta bëjë vetëm ndërmarrja e autorizuar, së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

Neni 26

Shpenzimet e ujit paguhen sipas tarifës për 1 m³ ujë. Sasia e ujit të shpenzuar vërtetohet me anë të ujëmatësit.

Neni 27

- 27.1 Për shfrytëzimin e ujit dhe të shërbimeve nga rrjeti i ujësjellësit dhe i kanalizimit, paguhet kompensimi nga ana e konsumatorëve për ndërmarrjen e ujësjellësit dhe kanalizimit.
- 27.2 Tarifën mbi lartësinë e këtij kompensimi e cakton Autoriteti Rregullativ i Ujit (ARrU).

Neni 28

- 28.1 Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, do t'i shkyç shfrytëzuesit e ujit nga ujësjellësi publik, sipas Rregullores së brendshme të Ndërmarrjes.
- 28.2 Kyçja e sërishme bëhet me kompensimin e shpenzimeve nga shfrytëzuesi i ujit.

Neni 29

Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, nuk do të kërkojë kompensim për ujin e shpenzuar nga hidrantët publikë që harxhohen për fikjen e zjarreve, sipas Ligjit për shërbimet e ujit.

Neni 30

Ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, është e obliguar që ta pengojë çdo derdhje të paarsyeshme të ujit.

Neni 31

- 31.1 Në rast të thatësisë dhe pengesave tjera të furnizimit me ujin e pijes, ndërmarrja së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit, është e obliguar që të ndërmarrë masa teknike të kufizimit të shpenzimit të ujit, sipas Planit për menaxhimin e thatësirave.
- 31.2 Në këto raste, ndërmarrja nga paragrafi paraprak, iu propozojë organeve përkatëse të Administratës komunale të Prizrenit që, me urdhëresë të veçantë, të caktojë mënyrën e shpenzimit të ujit, kufizimin ose ndalimin e shpenzimit të ujit për disa konsumatorë të caktuar. Urdhëresën e zbaton ndërmarrja dhe Inspektorati komunal.

Neni 32

- 32.1 Përmes hidrantëve të rrjetit të ujësjellësit publik, ujin mund ta marrin vetëm ndërmarrjet dhe subjektet tjera, të cilat e kanë pëlqimin paraprak nga ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit.
- 32.2 Shërbimi publik i zjarrfikësve ka të drejtë të marrë ujin nga ujësjellësi publik gjatë intervenimit në fikjen e zjarreve.
- 32.3 Të gjithë konsumuesit tjerë të ndërmarrjeve apo personat fizikë, të cilët marrin sasi të caktuara të ujit për kryerjen e punëve ndërtimore e të ngjashme, patjetër duhet të kenë leje të posaçme nga ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit. Shfrytëzimi i ujit nga rrjeti i hidrantëve publikë rregullohet me kontratë të posaçme, ndërmjet ndërmarrjes dhe shfrytëzuesit.

Neni 33

Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së ujësjellësit dhe të kanalizimit, është e obliguar që rregullisht të mirëmbajë dhe ta bëjë pastrimin e përcjellësve dhe të pusetave për kanalizimin e ujërave fekale dhe atmosferike, në mënyrë që në çdo kohë t'i përgjigjet destinimit të tyre. (Ndërmarrja në bashkëpunim me komunën).

Neni 34

- 34.1 Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët për mirëmbajtjen e ujësjellësit dhe të kanalizimit, është e obliguar që, pas punëve të kryera ndërtimore në kyçje, terrenin (vendin e punimeve) ta kthejë në gjendje të rregullt, si ka qenë më parë.
- 34.2 Obligimi nga paragrafi i mëparshëm, bie në barrë të shfrytëzuesit, respektivisht të investuesit, nëse këto punë i kryen vet (rrëmihja dhe mbulimi i vendit ku është kryer lidhja).

Neni 35

Kryesit e punëve (personat juridikë dhe fizikë), menjëherë pas kryerjes së punëve, në afatin të cilin e ka caktuar organi kompetent me rastin e dhënies së lejes për kyçje, janë të obliguar që materialin e tepërt ta mënjanojnë nga rrugët, trotualet, sipërfaqet publike dhe terrenin ta kthejnë në gjendjen e mëparshme,

Neni 36

36.1 Gjatë shfrytëzimit të rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ndalohet:

- 36.1.1 hedhja e mbeturinave, hirit, çimentos, rërës e fundërrinave tjera të ngjashme në rrjetin shtëpiak të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të cilat mund të shkaktojnë prishjen dhe dëmtimin e funksionimit të rregullt të pajisjeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 36.1.2 derdhja e lëndëve të ngurta dhe materialit tjetër të ngjashëm në përcjellësit e ujit të rrugëve;
- 36.1.3 hedhja e mbeturinave nga pastrimi i oborreve dhe shesheve në ujëmbledhës;
- 36.1.4 derdhja në kanalizim e ujit dhe lëngjeve të tjera, temperatura e të cilave është më e lartë se 100 C, ose me përmbajtje të thartirave të dëmshme, të alkaleve dhe të kripërave;
- 36.1.5 derdhja e ujërave fundërrinore pa lejen e ndërmarrjes së cilës i besohen punët e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 36.1.6 hedhja e material ndezës në kanal, i cili mund të shkaktoj zjarr;
- 36.1.7 parkimi i automjeteve apo vënia e materialit ose mbeturinave në dhe mbi objektet e ujësjellësit dhe të kanalizimit;
- 36.1.8 Çfarëdo dëmtimi në objektet e ujësjellësit dhe kanalizimit.

Gjelbërimi publik

Neni 37

- 37.1 Me qëllim të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra dhe zgjerimit e kultivimit të këtyre sipërfaqeve në territorin e qytetit, vendbanimeve dhe fshatrave, ato në mbikëqyrje dhe në mbrojtje, në mënyrën si është përcaktuar me këtë Rregullore, parashihen:
 - 37.1.1 sipërfaqet publike të gjelbra: rendet e drurëve, gjelbërimi i ambientit në lagjet e banimit, gjelbërimi afër rrugëve të trafikut, pyjet e të ngjashme;
 - 37.1.2 pjesët mbrojtëse të lagjeve në qytet dhe në paralagjet e qytetit, në vendet e banuara dhe në zonat industriale (pjesët mbrojtëse të gjelbërimit dhe të sipërfaqeve tjera ujore), përveç tokës mbrojtëse pyjore, e cila është pjesë përbërëse e sistemit për mbrojtje nga vërshimet;
 - 37.1.3 sipërfaqet e gjelbra të ndërmarrjeve, organizatave e subjekteve tjera;
 - 37.1.4 sipërfaqet e gjelbra me destinim të veçantë dhe të dobishëm (gjelbërimi rreth varrezave, rreth objekteve kulturore historike dhe objekteve tjera me rëndësi);
 - 37.1.5 sipërfaqet e gjelbra për sport dhe rekreacion (oborret e shkollave dhe ushtrimoret, terrenet sportive, qendrat, vendet për rekreacion e të ngjashme) dhe objekteve komunale, dhe
 - 37.1.6 gjelbërimi i oborreve të shtëpive, të vendeve për vikend, hapësirave të kampeve, lokaliteteve turistike dhe shëtitoreve.
 - 37.1.7 Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk kanë të bëjnë me pyjet, tokën bujqësore dhe pjesët e natyrës për të cilat aplikohen dispozitat tjera ligjore.

Neni 38

- 38.1 Gjelbërimi i sipërfaqeve në vendet e sapondërtuara, parashihet me projektet e ndërtimeve të reja dhe bëhet me anë të kontrollit profesional të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.
- 38.2 Zgjerimi dhe ngritja e sipërfaqeve të reja, bëhet me anë të projektit për ndërtimin dhe rregullimin e sipërfaqeve të reja, në harmoni me planin zhvillimor urban të Komunës dhe planet për zonat e veçanta .

Neni 39

- 39.1 Projektet e të gjitha objekteve që do të ndërtohen në pjesët e territorit të komunës, në vete duhet të përfshijnë edhe planet dhe skicat e tokës për gjelbërim, të cilat sipas lokacioneve u takojnë atyre objekteve.
- 39.2 Projektet të cilat nuk i kanë planet - skicat për gjelbërim, do të konsiderohen si jo të plota dhe nuk mund të lejohen.
- 39.3 Nëse bëhet ndërtimi në kundërshtim me pikat: 39.1 dhe 39.2 të këtij neni, Inspekcioni komunal kompetent do të ndalojë kryerjen e punimeve deri sa ato masa nuk ndërmerren.

Neni 40

Të gjitha planet – skicat e gjelbërimit, duhet të jenë të harmonizuara me planin e gjelbërimit të komunës, respektivisht me konceptet e planeve rregulluese urbane, për të cilat duhet të kujdeset projektuesi, respektivisht investuesi.

Neni 41

- 41.1 Punët rreth gjelbërimit të tërësishëm të lokacioneve, investuesit janë të detyruar t'i kryejnë para se të bëhet pranimi teknik i punëve ndërtimore dhe punëve të tjera nëpër objekte investuese.
- 41.2 Komisioni për pranimin teknik të objekteve, është i detyruar që njëkohësisht të bëjë edhe pranimin teknik të punëve të gjelbërimit.

Neni 42

Sipërfaqet e gjelbëruara në mënyrë jo të rregullt në tokën e urbanizuar ndërtimore, shfrytëzuesi do t'i gjelbërojë në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, më së voni në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 43

Para se të bëhet gjelbërimi i sipërfaqeve të parapara me këtë Rregullore, shfrytëzuesit e tokës janë të obliguar të marrin pëlqimin e organit kompetent të Administratës.

Neni 44

- 44.1 Punët rreth gjelbërimit, si kultivimi i drurëve, mirëmbajtja dhe mbrojtja e sipërfaqes publike dhe sipërfaqeve tjera të gjelbra, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, i kryejnë pronarët dhe ndërmarrja së cilës i besohen këto punë.
- 44.2 Të drejtat dhe obligimet lidhur me kryerjen e punëve nga paragrafi paraprak, do të rregullohen me kontratë.

Neni 45

Nëse shfrytëzuesit e tokës nuk e kryejnë gjelbërimin në afatin e paraparë, organi kompetent i Komunës do ta urdhërojë ndërmarrjen e cila merret me këto punë, që ta bëjë gjelbërimin me shpenzimet e shfrytëzuesit.

Neni 46

Ndalohet shfrytëzimi i sipërfaqeve të gjelbra publike jashtë destinimeve të tyre themelore, me përjashtim të rasteve kur këtë e kërkon interesi publik.

Neni 47

Ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së rregullt të gjelbërimit, është e obliguar që në parqe, në sheshe dhe në vende të tjera, të vendosë dhe të mirëmbajë numër të mjaftueshëm të shportave për mbeturina të imëta dhe numër të mjaftueshëm të ulëseve për pushim.

Neni 48

Vendosja e instalimeve nëntokësore (objekteve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, elektro-distributimit dhe të rrjetit të PTK-së e të ngjashme) në sipërfaqet e gjelbra, bëhet në distancë prej 2 m nga fidani ekzistues, por me lejen paraprake për gropim nga organi i administratës dhe me obligimin e investuesit që ta kthejë terenin në gjendjen e mëparshme, sipas kushteve të përshkruara në leje dhe në projekt.

Neni 49

Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit, është e obliguar:

- t'i largojë menjëherë degët e dëmtuara nga kushtet natyrore atmosferike ose nga shkaktarë të tjerë,
- ta largojë barin e kositur dhe materialin e mbetur në sipërfaqet e gjelbra publike.

Neni 50

Degët e drurëve në sipërfaqet e gjelbra publike, të cilat pengojnë kabllot ajrore (rrjetin elektrik, atë telefonit e të ngjashme), duhet të shkurtohen ose të evitohen vetëm nga ana e ndërmarrjes së cilës i besohen punët, dhe e cila është e obliguar që këtë ta bëjë me kërkesën dhe kompensimin e pronarit të këtyre kablllove.

Neni 51

Dëmet e bëra në sipërfaqe të gjelbra nga ana e personave juridikë e fizikë, me kërkesën e ndërmarrjes së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit, do të vlerësohen nga ana e komisionit, të cilin e emëron organi i Administratës kompetent për punët komunale.

Neni 52

Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët e mirëmbajtjes së gjelbërimit, është e obliguar që, në vend të dukshëm, t'i vendosë shënimet me vërejtjet apo ndalesat që kanë të bëjnë me këto sipërfaqe.

Neni 53

53.1 Në sipërfaqet e gjelbra publike ndalohet:

- 53.1.1 këputja dhe shkulja e drurëve, e barit dhe e bimëve të tjera, thyerja e degëve apo fidanëve e të ngjashme;
- 53.1.2 vozitja dhe parkimi i automjeteve (i të gjitha llojeve), si dhe shkarkimi dhe deponimi i çfarëdo materiali në këto sipërfaqe;
- 53.1.3 dëmtimi i ulëseve, i shportave, i rekuizitave, i hidrantëve dhe i instalimeve tjera, dhe kalimi për këmbësorë;
- 53.1.4 largimi, djegia, dëmtimi i shenjave dhe mbishkrimeve të vendosura me qëllim të mbajtjes së rendit;
- 53.1.5 shfrytëzimi i sipërfaqeve të gjelbra, publike dhe të tjera, jashtë destinimeve të tyre themelore, ose kryerja e çfarëdo veprimtarie në to pa lejen e veçantë;
- 53.1.6 vendosja dhe derdhja e çfarëdo lënde dhe materiali tjetër nëpër drurë dhe në pjesët tjera, si dhe shkurtimi i drurëve dhe bimëve të tjera pa lejen e organit kompetent për punët komunale;
- 53.1.7 rrëzimi dhe zhvendosja e ulëseve, rekuizitave sportive, rrethojave e të ngjashme;
- 53.1.8 shtrirja dhe qëndrimi nëpër sipërfaqe të gjelbra;
- 53.1.9 lëvizja jashtë rrugicave të shënuara për këmbësorë;
- 53.1.10 lëshimi i ujërave të zeza në parqe dhe sipërfaqe tjera publike;
- 53.1.11 keqpërdorimi i ujit në fontana (hyrja në to, larja e personave dhe gjësendeve, turbullimi i ujit dhe hedhja e fundërrinave dhe mbeturinave tjera);
- 53.1.12 gjuajtja e zogjve dhe kafshëve jashtë vendeve të parapara për atë qëllim;
- 53.1.13 kositja dhe largimi i barit nga sipërfaqet e gjelbra pa lejen e organit kompetent për punë komunale;
- 53.1.14 vendosja e lojërave dhe rekuizitave tjera për qëllime komerciale pa lejen e organeve kompetente të Administratës komunale;
- 53.1.15 shfrytëzimi për kullosa të kafshëve dhe shpezëve shtëpiake;
- 53.1.16 ndezja e zjarreve dhe djegia e gjetheve;
- 53.1.17 hedhja e shtazëve dhe shpezëve të ngordhura dhe fundërrinave të tjera;
- 53.1.18 rrëmihja për çfarëdo destinimi si dhe veprimet tjera që i dëmtojnë këto hapësira pa u pajisur me leje nga organi kompetent.

Sipërfaqet publike

Neni 54

Sipërfaqet publike, sipas kësaj Rregulloreje, konsiderohen ato sipërfaqe, në të cilat është i lejuar aderimi (qëndrimi) në numër të pakufizuar i personave, si:

- sipërfaqet e trafikut publik (rrugët dhe sipërfaqet tjera për trafik, trotuaret, rrugicat), shkollat, entet, objektet fetare dhe sipërfaqet tjera publike;
- stacionet e autobusëve, të trenave, vendqëndrimet, depot e karburantit dhe hapësirat për parkim;
- sipërfaqet publike dhe të gjelbra, (parqet, drurët, sipërfaqet me bar, sipërfaqet për pushim dhe rekreacion);
- terrenet argëtuese dhe sportive;
- sipërfaqet me ujë (plazhet afër lumit, pishinat) etj;
- tregjet (tregjet e gjelbra, të bulmetit dhe të kafshëve), vendet për grumbullimin e prodhimeve bujqësore, të qumështit dhe të kafshëve;
- sipërfaqet e hapura ndërmjet dhe rreth banesave, si dhe tokat e pandërtuara (trojet, vendet për shkarkim dhe oborret e ndërtesave të banimit);
- sallat e kinemave dhe të tjera, të cilat shërbejnë për tubime publike të qytetarëve;
- dhe hyrjet në varreza dhe varrezat;
- krojet publike, etj.

Rrugët dhe trotuaret

Neni 55

Rrugët janë sipërfaqe publike, me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, të cilat mund të shfrytëzohen nga pjesëmarrësit në komunikacion sipas kushteve të shpallura nga organi kompetent.

Neni 56

Rrugët mbahen në gjendje të rregullt dhe shfrytëzohen në bazë të destinimit.

Ndërmarrja e autorizuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale, është e obliguar që t'i evitojë të gjitha dëmtimet nëpër rrugët e trafikut dhe trotuaret, si dhe t'i mbajë ato në gjendje të rregullt.

Neni 57

- 57.1 Në sipërfaqet e rrugëve të shtruara me shtresën e asfaltit, ndalohet lëvizja e të gjitha mjeteve transportuese dhe të tjera që mund ta dëmtojnë rrugën, siç janë: makinat me zinxhirë, llojet e ndryshme të makinave ndërtimore dhe mjetet tjera të ngjashme.
- 57.2 Transporti i makinave dhe i mjeteve tjera që e dëmtojnë rrugën, mund të bëhet vetëm me mjete transportuese të veçanta. Njëherësh, ndalohet qarkullimi i automjeteve me peshë mbi peshën e lejuar në ato rrugë.

Neni 58

- 58.1 Trotuaret janë sipërfaqe publike, të cilat shfrytëzohen për ecjen e këmbësorëve.
- 58.2 Shiriti i rrugës shfrytëzohet për lëvizjen e mjeteve të komunikacionit.
- 58.3 Sipërfaqet tjera publike, si: sheshet, parqet dhe të ngjashme, shfrytëzohen në bazë të destinimit të tyre.

Neni 59

Në sipërfaqet e trotuareve nuk lejohet shitja, vendosja e gjësendeve për zhvillimin e ndonjë veprimtarie tjetër, pa lejen e organeve kompetente komunale.

Neni 60

- 60.1 Shkarkimi i mallit nëpër trotuare, lejohet vetëm atëherë kur kjo nuk mund të bëhet në orët e hershme të mëngjesit ose të mbrëmjes, nëpër oborret e ndërtesave, respektivisht të hapësirave punuese.
- 60.2 Njëherësh, malli duhet të largohet menjëherë nga trotuari, më së voni në afat prej një ore pas shkarkimit të mallit.
- 60.3 Trotuaret mund të shfrytëzohen për shkarkimin e mallit dhe të materialit për ngrohje, vetëm me lejen paraprake të DSHP -së.

Neni 61

- 61.1 Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, janë të obliguar që trotuaret, shiritat e rrugëve dhe sipërfaqet tjera publike, t'i shfrytëzojnë në mënyrën si parashihet me këtë Rregullore.
- 61.2 Nëse gjatë shfrytëzimit të këtyre sipërfaqeve shkaktohet dëmtimi i tyre, shfrytëzuesit janë të obliguar që t'i kthejnë ato në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e veta.
- 61.3 Ndalohet vendosja e karrigeve, tavolinave, tezgave, ambalazhit, mallrave etj. në trotuare, shesheve dhe rrugë, përveç personave fizikë dhe juridikë që janë të pajisur

- me leje nga DUPH.
- 61.4 Ndalohet hedhja e dheut, rërës, gurëve, drunjëve dhe materialit tjetër nëpër trotuare, shesheve, rrugë dhe sipërfaqe tjera të lira publike.

Neni 62

- 62.1 Për ndërtimin e objekteve komunale, të ujësjellësit dhe të kanalizimit, të rrjetit elektrik dhe të telefonisë, mund të lejohet gropimi i shiritit të rrugëve dhe trotuareve.
- 62.2 Gropimi i trotuareve dhe shiritit të rrugëve, nga paragrafi paraprak, mund të bëhet me lejen e organit kompetent të Komunës.
- 62.3 Rregullorja me të cilën lejohet gropimi i trotuareve, shiritit të rrugës dhe të sipërfaqeve publike, përveç kushteve të tjera, përmban edhe obligimin e shfrytëzuesve, respektivisht të investitorit, që shiritin e rrugës dhe trotuarin ta kthejnë në gjendje të mëparshme.
- 62.4 Pjesa e rrëmihur e rrugëve dhe trotuareve, rimbushet me zhavorr dhe shtresa e fundit me material ekzistues.
- 62.5 DUPH, para dhënies së lejes për gropimin e rrugëve dhe sipërfaqeve tjera publike, do të kërkojë që investitori më parë ta paguajë taksën për gropim, e paraparë me Rregulloren për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Ndricimi publik

Neni 63

Të gjitha rrugët e qytetit, gjatë natës duhet të jenë të ndriçuara:

- 63.1 Llambat elektrike për ndriçim publik duhet të jenë të vendosura në vendet që mundësojnë ndriçimin e tërësishëm të rrugëve, sipas normativave të përcaktuara;
- 63.2 Llambat e djegura, brenda 24 orëve, patjetër duhet të zëvendësohen me llamba të reja.

Neni 64

Për ndriçimin e rrugëve, ndërrimin e llambave të djegura dhe mirëmbajtjen e rrjetit ndriçues në gjendje të rregullt, kujdeset ndërmarrja së cilës i besohen punët e mirëmbajtjes së ndriçimit publik.

Neni 65

- 65.1 Kryerjen e punëve në rrjetin publik elektrik dhe telefonik, e bën vetëm ndërmarrja e autorizuar dhe e specializuar për këto punë.
- 65.2 Të gjitha shtyllat e ndriçimit publik, rrjetit telefonik dhe ato të rrjetit energjetik që janë të dëmtuara dhe paraqesin rrezik për jeten e qytetarëve duhet të ndërrohen nga ndërmarrjet e autorizuar.

Neni 66

66.1 Ndalohet:

- 66.1.1 Thyerja, djegia ose dëmtimi i instalimit elektrik publik në ndonjë mënyrë tjetër, shtyllave, kablllove, rrjetit të telefonit, mjeteve izoluese, trafostacioneve etj.;
- 66.1.2 Kryerja e punimeve në dhënien e lidhjeve për pajisjet shtëpiake, apo çfarëdo lidhje tjetër nga rrjeti i ndriçimit publik, shtyllave të instalimeve tjera, si dhe kontakti me to i personave të paaautorizuar.

Objektet e përkohëshme

Neni 67

67.1 Llojet e objekteve të përkohëshme, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje janë :

- Mbishkrimi (firmat), panotë dhe tabelat reklamuese;
- Ekranet elektronike reklamuese;
- Tabelat reklamuese me kinoprojektor,
- Tabelat reklamuese digjitale,
- Pllakatet reklamuese,
- Billboardet,
- Vitrina të ndriçuara,
- Panotë murale,
- Banerët
- Kabinat (foltoret) telefonike,
- Strehët për pritje të autobusëve
- Kiosqet (deri më 8m²),
- Bankomatet (deri më 6m²)
- Kamp-shtëpizat (deri më 8m²).

67.2 Objekte të përkohshme lëvizëse, sezonale dhe ekspozuese konsiderohen:

- Tavolinat dhe karriget të cilat vendosen në hapësirat pranë lokaleve hoteliere (restoranteve);
- Pajisjet për shitje të akulloreve, pufkave, misrit, gështenjave, pomfritit, brumërave të ndryshme dhe artikujve të ngjashëm;
- Automjetet lëvizëse për shitje të ushqimit të shpejtë;
- Tendat (çadrat) lëvizëse me mekanizëm dhe çadrat e veçanta;
- Lojërat (lunaparqet, autoparqet, cirqet, ringishpilet dhe poligonet për ngasjen e automjeteve motorike) për fëmijë dhe të rritur;
- Lojëra të ndryshme për fëmijë dhe të rritur;
- Gjeneratorët statik për furnizim me energji alternative në hapësira publike;
- Veturat për ekspozim me qëllim promovimi në hapësira publike;
- Objekte tjera të pa specifikuar në hapësira publike (veturat e braktisura, pengesa të ndryshme etj).

67.3 Kompetenca për lëshimin dhe vazhdimin e lejeve për vendosjen e objekteve me karakter të përkohshëm sipas kësaj Rregulloreje i takon DUPH-së, me pëlqim paraparak të lëshuar nga ana e DShP-së dhe për zonën historike të qytetit me pëlqim të QRTK-së në Prizren

Kriteret e vendosjes së objekteve të përkohshme, menaxhimi, rregullimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e hapësirave për vendosjen e objekteve për reklamim

Neni 68

Menaxhimin e punëve për rregullim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të hapësirave publike si dhe vendosjen e objekteve për reklamim mund t'a ushtrojë edhe personi juridik apo fizik, bëhet nëpërmjet Ligjit për Prokurimin Publik (në tekstin e mëtejme personi juridiko/fizik i kontraktuar nga Komuna), ose me një marrëveshje të veçantë, Komuna mund të lidhë një kontratë me ndërmarrjet publike për shfrytëzim dhe mirëmbajtjen e hapësirave dhe objekteve publike si dhe zhvillimin e veprimtarisë për reklamim duke respektuar kushtet që i parashtron DUPH-ja.

Neni 69

- 69.1 Mbishkrim apo firmë konsiderohen të gjitha shënimet identifikuese të veprimtarisë afariste (biznesit) të vendosura në hapësirën mbi derë të hyrjes së objektit apo të shkruar në vitrinat e lokalit afarist. Firma duhet të përmbajë emrin e biznesit, emrin e pronarit të biznesit, adresa-selia ku zhvillohet biznesi dhe shënime tjera identifikuese si: (numri i telefonit-faksit, e-mail etj.)
- 69.2 Vendosja e firmës, me shënimet e cekura me lartë, është obligative për të gjitha subjektet afariste.
- 69.3 E shkruar dhe e vendosur në pronë publike apo private, me qëllim të reklamimit të veprimtarisë afariste, konsiderohet reklamë, pano reklamuese apo tabelë reklamuese, e cila mund të jetë edhe ndriçuese.
- 69.4 Për vendosjen-shkruarjen e panos reklamuese apo tabelës reklamuese, paraprakisht duhet të merret leja përkatëse nga DUPH-ja, e cila lëshohet në bazë të kërkesës së paraqitur dhe në afat të cilen e kërkon paraqitësi i kërkesës. Pas skadimit të afatit, të përcaktuar në lejen e lëshuar, personi fizik apo juridik, duhet të paraqesë kërkesë për vazhdimin e saj ose me shkrim të lajmërojë organin i cili e ka lëshuar lejen se reklamën e vendosur-shkruar, apo firmën ndriçuese e ka mënjeluar—hequr.
- 69.5 Pas pranimit të kërkesës, personi i autorizuar duhet të dalë në vendngjarje për të ekzaminuar dhe verifikuar: dimensionet, shfrytëzueshmërinë e reklamës (një, dy, tre apo katër anësorë) së thjeshtë apo ndriçuese dhe rregullsitë apo parregullsitë e vendosjes së tyre
- 69.6 Me anë të një kërkesë mund të kërkohej vendosja e një apo më tepër reklamave-tabelave reklamuese dhe pagesa bëhet për secilën prej tyre. Për reklamat-tabelat reklamuese disa krahësh, pagesa bëhet për secilin krahë të dukshëm.
- 69.7 Kërkesës (aplikacionit) duhet t'i bashkëngjitet:
- 69.7.1 Fotokopja e letërnjoftimit të aplikantit,
 - 69.7.2 Certifikata mbi regjistrimin e biznesit pranë Institucionit përkatës,
 - 69.7.3 Skica me dimensione dhe përshkrimi teknik.
 - 69.7.4 Certifikata e prones
 - 69.7.5 Lokacioni
- 69.8 Për vendosjen e reklamës, panos reklamuese dhe tabelës reklamuese sipas lejes së Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë, caktohet vlera për pagesë sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Ekranet elektronike reklamuese, tabelat reklamuese me kinoprojektor dhe tabelat reklamuese digjitale

Neni 70

- 70.1 Ekranet elektronike reklamuese, tabelat reklamuese me kinoprojektor dhe tabelat reklamuese digjitale, mund të vendosen nga secili subjekt afarist që bënë reklamim të veprimtarisë së vet afariste apo reklamim të bizneseve tjera, vetëm në bazë të lejes së lëshuar nga DUPH-ja. Ndriçimi i kutisë së reklamës duhet të jetë uniform dhe me intensitet konstant, me ngjyrë të bardhë, i harmonizuar me intensitetin e ndriçimit publik përgjatë rrugës, duke filluar nga 200-300 lux. Dritaret e reklamave gjithashtu mund të mos ndriçohen.
- 70.2 Pas skadimit të afatit, të përcaktuar në lejen e lëshuar, personi fizik apo juridik, duhet të paraqesë kërkesë për vazhdimin e saj, ose me shkrim të lajmëron organin i cili e ka lëshuar lejen se e ka mënjeluar—hequr pajisjet reklamuese të cekura në nenin 70.1.
- 70.3 Pas pranimit të kërkesës, personi i autorizuar duhet të dalë në vend shikim për të ekzaminuar dhe verifikuar: dimensionet dhe rregullsitë apo parregullsitë e vendosjes së tyre.
- 70.4 Kërkesës (aplikacionit) duhet t'i bashkëngjitet:

- 70.4.1 Fotokopja e letërnjoftimit të aplikantit,
- 70.4.2 Certifikata mbi regjistrimin e biznesit pranë Institucionit përkatës,
- 70.4.3 Skica me dimensione, instalimi elektrik i reklamës dhe mënyra se si do të furnizohet me rrymë kjo reklame,
- 70.4.4 Atesti statik dhe i qëndrueshmërisë (stabilitetit).
- 70.4.5 Certifikata e prones
- 70.4.6 Lokacioni
- 70.5 Në emër të shfrytëzimit të sipërfaqes për vendosjen e ekraneve elektronike reklamuese, tabelave reklamuese me kinoprojektor dhe tabelave reklamuese digjitale caktohet vlera për pagesë sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Pllakatet reklamuese, billboardet, vitrinat e ndriçuara, panotë, muralet dhe banerët

ndriçuara, panotë, muralet dhe banerët

Neni 71

- 71.1 Panotë e mëdha reklamuese janë reklama të cilat shfrytëzohen për reklama komerciale dhe të cilat mund të vendosen në pllato apo nëpër mure. Ato pano reklamuese të cilat vendosen si vetë mbajtëse mund të jenë:
 - Billboardet,
 - Vitrina të ndriçuara,
 - Muralet
 - Banerët.
- 71.2 Billboarde janë reklama prej materiali të plastifikuar apo të ngjashme me material në të cilat janë të shtypura reklammat apo shërbimet afariste. Mund të vendosen në objektet sportive, biznese-afariste, objekte banuese dhe në terasa të kafiterive.
- 71.3 Vitrina të ndriçuara, janë tabela me ndriçim të integruar në të cilat posterat dhe sendet reklamuese vendosen brenda kutisë së xhamit. Ndriçimi i kutisë së reklamës duhet të jetë uniform dhe me intensitet konstant, me ngjyrë të bardhë, i harmonizuar me intensitetin e ndriçimit publik përgjatë rrugës, duke filluar nga 200-300 lux. Dritaret e reklamave gjithashtu mund të mos ndriçohen.
- 71.4 Muralet janë vepra arti të pikturuara ose të aplikuara direkt në një mur ose sipërfaqe tjetër të përhershme. Karakteristikë dalluese e pikturës murale është se elementet arkitektonike të hapësirës së dhënë janë futur në mënyrë harmonike në figurë.
- 71.5 Banerët janë reklama, flamuj reklamues e të ngjashme, kanë për qëllim informimin ditor të qytetarëve për tema të ndryshme si sociale, kulturore, sportive.
- 71.6 Ky lloj i reklamave i referohet lokacioneve brenda zonës së qytetit (nëpër sipërfaqe gjelbëruese dhe në afërsi të kryqëzimit të rrugëve) si dhe jashtë zonave të qytetit (përballë rrugëve magjistrale apo rajonale). Tabelat mund të vendosen në zona publike, toka dhe ndërtesa në pronësi private. Ato duhet të mbahen në një gjendje të rregullt dhe korrekte, në mënyrë që të mos prishin pamjen e qytetit. Tabelat reklamuese, ngjyra, pamja ose vendi i vendosjes nuk duhet të imitojnë shenjat e trafikut, errësoj një shenjë të trafikut ose dukshmërinë në një kryqëzim dhe të errësoj vëmendjen e pjesëmarrësve në trafik. Nëse paneli është i ndriçuar ose ka ndriçim të integruar, ndriçimi duhet të jetë i përhershëm, me intensitet uniform dhe të lejueshëm të drejtuar, në mënyrë që të mos verbojë pjesëmarrësit në trafik. Nuk lejohet vendosja e reklamave ndriçuese në semaforë dhe në të gjitha shenjat e komunikacionit.
- 71.7 Kërkesës për vendosjen e këtyre reklamave duhet t'i bashkëngjitet:
 - 71.7.1 Kopje e letërnjoftimit,
 - 71.7.2 Certifikata e biznesit;
 - 71.7.3 Pëlqimi nga Institucioni përkatës,
 - 71.7.4 Certifikata e prones,

- 71.7.5 Lokacioni,
- 71.7.6 Skica me dimensione, instalimi elektrik i reklamës dhe mënyra se si do të furnizohet me rrymë kjo reklame,
- 71.7.7 Atesti statik dhe i qëndrueshmërisë (stabilitetit),
- 71.8 Organizatat e ndryshme-jo profitabile dhe jo qeveritare, të cilat vendosin përkohësisht pllakatë, përmes të cilave organizojnë manifestime të ndryshme, janë të liruar nga pagesa e tarifës për vendosjen e tyre. Afati i qëndrimit të reklamës mund të jete prej një 1-14 ditë.
- 71.9 Shtyllat për flamuj-janë shtyllat në të cilat vendosen flamujt. Këto shtylla vendosen para objekteve apo para pronave publike ku ka mundësi për vendosjen e tyre dhe ku nuk paraqesin pengesë për të tjerët.
- 71.10 Në emër të shfrytëzimit të sipërfaqes publike për vendosjen e billboardëve, panove, muraleve, vitrinave ndriçuese dhe banerëve caktohet vlera për pagesë sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Kabinat (foltoret) publike telefonike, bankomatet etj

Neni 72

- 72.1 Për shfrytëzimin e sipërfaqes publike për vendosjen e kabinave telefonike, bankomateve etj, paraprakisht duhet të kërkohet dhe merret leja përkatëse nga DUPH, e cila lëshohet në bazë të kërkesës së paraqitur për afatin e kërkuar.
- 72.2 Për vendosjen e kabinave publike telefonike, bankomateve, etj kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
 - 72.2.1 Kopje e letërnjoftimit të pronarit,
 - 72.2.2 Certifikata e biznesit,
 - 72.2.3 Pëlqimi nga Institucioni përkatës,
 - 72.2.4 Skica me dimensione dhe përshkrimi teknik,
 - 72.2.5 Atesti statik i qëndrueshmërisë (statika tokëzimi), dhe
 - 72.2.6 Skica e lokacionit.
- 72.3 Tarifa për një kabinë (foltore) telefonike, bankomat etj, të vendosur në sipërfaqe publike caktohet vlera për pagesë sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Strehët për pritje të autobusëve

Neni 73

- 73.1 Për vendosjen e strehëve për pritje të autobusëve brenda dhe jashtë qytetit, duhet të merret leje nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, pëlqimi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe nëse është brenda qendrës historike të Prizrenit duhet të merret pëlqimi nga QRTK-ja.
- 73.2 Parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë planin hartografik të pikave të planifikuara për vendosjen e strehëve për pritje dhe dizajnin e tyre. Për vendosjen e strehëve për pritje të autobusëve, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
 - 73.2.1 Kopje e letërnjoftimit të pronarit,
 - 73.2.2 Certifikata e biznesit,
 - 73.2.3 Pëlqimi nga Institucioni përkatës,
 - 73.2.4 Skica me dimensione dhe përshkrimi teknik,
 - 73.2.5 Atesti statik i qëndrueshmërisë (statika tokëzimi), dhe
 - 73.2.6 Skica e lokacionit.

Kiosqet

Neni 74

- 74.1 Kiosqe konsiderohen objektet e përkohshme të tipit montues/demontues, të punuara nga materiali i lehtë ndërtimor si: druri, plastika, metali, apo duke i kombinuar këto materiale, me sipërfaqe deri në 8 m².
- 74.2 Kiosqet duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë standarde (e cila do të përcaktohet në bazë konkursit publik) për shitje vetëm përmes sportelit dhe jo jashtë hapësirës së saj, në të kundërtën nuk mund të lejohet vendosja e tyre.
- 74.3 Leja nga DUPH do të jepet vetëm për kiosqe që janë të destinuara për shitjen e shtypit ditor, revistave, duhanit, librave, lotarive, bizhuterive, kozmetikës, suvenireve, luleve, kafes, bukës, brumërave, si dhe të gjërave ushqimore me ambalazhime të vogla.
- 74.4 Ndalohet ndërrimi i destinimit, shitja e çfarëdo malli tjetër si dhe ndërrimi i veprimtarisë, në kundërshtim me lejen e lëshuar nga Institucioni përkatës.
- 74.5 Në emër të shfrytëzimit të sipërfaqes për vendosjen e kiosqeve caktohet vlera për pagesë sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Vendosja e tavolinave dhe karrigeve (trotuare, sipërfaqe tjera publike)

Neni 75

Pronarëve të lokaleve afariste të cilët ushtrojnë veprimtarinë zejtare–tregtare u lejohet shfrytëzimi i përkohshëm i rrugëve – trotuareve, në hapësirat e caktuara, për vendosjen e tavolinave dhe karrigeve, duke pasur parasysh ruajtjen e karakterit historik të zonës, ofrimin e qasjes së lirë për këmbësorë dhe sigurinë e lëvizjes së automjeteve të nevojshme për banorët të cilët jetojnë në atë zonë, furnizimi i lokaleve dhe qarkullimi i automjeteve për emergjencë.

Neni 76

Vendosja e tavolinave dhe karrigeve para lokaleve afariste në qytetin e Prizrenit lejohet nga DUPH-ja.

Neni 77

- 77.1 Për vendosjen e tavolinave në hapësirat pranë lokaleve afariste, hapësira ku mund të mbulohet me tenda ose mbulesa të përkohshme, ku ushtrohet veprimtari shërbyese hoteliere, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
 - a) Kopje e letërnjoftimit të pronarit,
 - b) Certifikata e biznesit,
- 77.2 Leja për vendosjen e këtyre objekteve, do të lëshohet për periudhën kohore nga data 1 Prill deri më datën 30 Shtator, që konsiderohet si (periudhë sezonale). Ndërsa për muajt në vijim nëse e shfrytëzojnë hapësirën publike, do të paguhet 50% e taksës sipas rregullores në fuqi.
- 77.3 Tarifa për vendosjen e tavolinave në këto hapësira caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.
- 77.4 Nuk lejohet dhënia në shfrytëzim tek sipërfaqet publike – trotuaret me gjerësi më të vogël se 1.5m.

Shfrytëzimi i hapësirave publike pranë lokaleve në të cilat ushtrohet veprimtari tregtare

Neni 78

- 78.1 Subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari tregtare me mallra ushqimore dhe tekstil, nuk mund t'u jepet në shfrytëzim sipërfaqe publike me qëllim të ekspozimit të hapur.
- 78.2 Subjektet afariste që ushtrojnë veprimtari tregtare me mallra ushqimore dhe tekstil, mund t'u jepet në shfrytëzim sipërfaqja publike, për ekspozimin e mbrojtur të mallit, përmes vitrinave lëvizëse, vetëm në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë Rregullore.
- 78.3 Subjektet afariste, që ushtrojnë veprimtari tregtare me mallra që nuk janë ushqimor dhe tekstil, mund tu jepet në shfrytëzim hapësira publike sipas kriterëve të përcaktuara me këtë Rregullore, për ekspozim të hapur, në shtande lëvizëse vertikale me gjerësi $b=60$ cm.
- 78.4 Për vendosjen e këtyre vitrinave, para lokalit afarist, duhet të paraqitet kërkesë dhe të merret leja nga DUPH-ja për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të sipërfaqes publike.
- 78.5 Tarifa për vendosjen caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Tezgë e hapur dhe stinore

Neni 79

- 79.1 Lejohet vendosja e tezgave të hapura dhe stinore për shitjen e gjësëndeve si: librit jo shkollorë, fotografive artistike, panoramave, etj., në hapësirë maksimalisht deri në 2 m². Për vendosjen e këtyre tezgave kërkesës duhet t'i bashkëngjitet:
- 79.1.1 Kontrata për shfrytëzimin e lokacionit;
 - 79.1.2 Certifikata e regjistrimit të biznesit;
 - 79.1.3 Projekti i lokacionit me skicë;
 - 79.1.4 Kopja e dokumentit të identifikimit.
- 79.2 Tarifa për vendosjen e tezgave të hapura lëvizëse caktohet sipas rregullores për Taksa Komunale.
- 79.3 Procedura për marrjen e lejes është e njëjtë në të gjitha rastet, dhe pas skadimit të afatit konform me lejen e lëshuar, shfrytëzuesi është i obliguar që ta largojë tezgën dhe sipërfaqen e shfrytëzuar ta kthejë në gjendjen e mëparshme.
- 79.4 Në emër të shfrytëzimit të sipërfaqes publike tarifa për vendosjen e tezgës së hapur lëvizëse stinore caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Vendosja e pajisjeve për shitje të akulloreve

Neni 80

- 80.1 Për vendosjen e pajisjeve si: frigoriferëve statik apo autofrigoriferëve, për kryerjen e shërbimeve të shitjes së akulloreve dhe pijeve freskuese, pjekjen e pomfritit, e të ngjashme, kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
- 80.1.1 Kopje e letërnjoftimit të pronarit,
 - 80.1.2 Skica e lokacionit,
 - 80.1.3 Certifikata e biznesit,
 - 80.1.4 Pëlqimi prej inspeksionit sanitar.
- 80.2 Tarifa për vendosjen e frigoriferëve statik apo autofrigoriferëve caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Vendosja e pajisjeve për shitje të pufkave (popcorn), misrit, gështenjave etj.

Neni 81

- 81.1 Vendosja e pajisjeve (aparateve) për shitje të këtyre artikujve, mund të lejohet vetëm në bazë të kushteve të lokacionit të cilat i përcakton Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë.
- 81.2 Për vendosjen e këtyre pajisjeve, lejohet vetëm 1.5 m² sipërfaqe.
- 81.3 Kërkesës duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
 - 81.3.1 Kopje e letërnjoftimit të pronarit;
 - 81.3.2 Skica e lokacionit;
- 81.4 Tarifa për vendosjen e këtyre pajisjeve caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Vendosja e automjetit lëvizës për shitje të ushqimit të shpejtë

Neni 82

- 82.1 Automjete lëvizëse për shitjen e ushqimeve të shpejta, konsiderohen auto-dyqani lëvizës, apo kioska lëvizëse.
- 82.2 Vendosja e këtij lloji të objekteve është e kufizuar në afat të përcaktuar kohor:
 - 82.2.1 Për një ditë apo disa ditë gjatë manifestimeve të ndryshme, panairove, lojërave të organizuara etj.
 - 82.2.2 Në periudhë sezonale deri në 3 (tre) muaj brenda një viti kalendarik.
- 82.3 Kërkesës për vendosjen e këtij lloji të objekteve, duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
 - 82.3.1 Kopje e letërnjoftimit të pronarit,
 - 82.3.2 Certifikata regjistrimit të biznesit ;
 - 82.3.3 Pëlqimi mbi kushtet higjieno-sanitare nga Inspeksioni sanitar.
- 82.4 Tarifa për vendosjen e këtyre pajisjeve caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Vendosja e tendave (çadrave) lëvizëse me mekanizëm

Neni 83

- 83.1 Vendosja e këtyre tendave lejohet për:
 - 83.1.1 Bizneset që ushtrojnë veprimtari shërbyese hoteliere,
 - 83.1.2 Bizneset që ushtrojnë veprimtari tregtare,
 - 83.1.3 Aktivitete për OJQ-të, aktivitete fetare dhe te ndryshme.
- 83.2 Kërkesës për vendosjen e këtyre tendave duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
 - 83.2.1 Kopja e letërnjoftimit të pronarit,
 - 83.2.2 Certifikata e regjistrimit të biznesit,
 - 83.2.3 Fotografia e lokacionit.
- 83.3 Tarifa për vendosjen e këtyre objekteve caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.
- 83.4 Nuk lejohet vendosja e çadrave në hapësirat publike, ku mund të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve, vendosja e së cilës ndikon në pamjen dhe imazhin e lokacionit ku është vendosur e njëjta.

- 83.5 Për objektet të cilat ndodhen brenda perimetrit të monumenteve trajtohen sipas ligjit për Trashëgimi Kulturorë.

Vendosja e lojërave (lunaparqet, autoparqet, cirqet, ringishpilet dhe poligonet për ngasjen e automjeteve motorike) për fëmijë dhe të rritur

Neni 84

- 84.1 Vendosja e lojërave (lunaparqet, autoparqet, cirqet, ringishpilet dhe poligonet për ngasjen e automjeteve motorike) për fëmijë dhe të rritur mund të bëhet jashtë zonës urbane sipas HZK-së (harta zonale e komunës), sipas kushteve të cilat i përcakton Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë.
- 84.2 Kërkesës për vendosjen e këtyre lojërave, duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
- 84.2.1 Kopja e letërnjoftimit të pronarit,
 - 84.2.2 Certifikata e biznesit,
 - 84.2.3 Fotografia e lokacionit,
 - 84.2.4 Atesti teknik dhe mekanik për disa lloje të lojërave.
- 84.3 Tarifa për vendosjen e këtyre objekteve caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Shfrytëzimi i hapësirës publike për vendosjen e gjeneratorëve statik dhe HVAC (Ventilimi dhe Klimatizimi)

Neni 85

- 85.1 Leja për vendosjen e gjeneratorëve statik jepet për afat kohor për 1 (një) vit, me të drejtë vazhdimi.
- 85.2 Kërkesës për vendosjen e gjeneratorëve statik, duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
- 85.2.1 Kopje e letërnjoftimit të pronarit,
 - 85.2.2 Certifikata e regjistrimit të biznesit,
 - 85.2.3 Specifikat e gjeneratorit (lloji),
 - 85.2.4 Atesti i mbrojtjes nga rreziqet,
 - 85.2.5 Atesti për siguri nga zhurma dhe akustika,
 - 85.2.6 Fotografia e lokacionit.
- 85.3 Tarifa për vendosjen e gjeneratorit statik caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.
- 85.4 Pronari është i obliguar të mbajë higjienë në hapësirën që vendosen këto pajisje.
- 85.5 Ndalohet vendosja e gjeneratorëve statik dhe HVAC (ventilimi dhe klimatizimi) në sipërfaqet publike ku paraqet çfarëdo pengese për qytetarë dhe ndotje të ambientit.

Veturat për ekspozim me qëllim promovimi në hapësira publike

Neni 86

- 86.1 Veturat për ekspozim me qëllim promovimi në hapësira publike lejohen në baze të lejes nga DUPH.
- 86.2 Kërkesës për vendosjen e automjetit për ekspozim duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
- 86.2.1 Kopja e letërnjoftimit,
 - 86.2.2 Certifikata e biznesit,
 - 86.2.3 Fotografia e lokacionit.

- 86.3 Tarifa për vendosjen e veturave për ekspozim caktohet sipas Rregullores për Taksa Komunale.

Neni 87

Kompetenca për lëshimin dhe vazhdimin e lejeve për vendosjen e objekteve me karakter të përkohshëm sipas kësaj Rregulloreje i takon DUPH-së, me pëlqim paraprak të lëshuar nga ana e QRTK-së (Qendra rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren) për zonën historike të qytetit dhe DShP-së.

Menaxhimi, rregullimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e hapësirave në bashkëpronësi për vendosjen e objekteve të përkohshme (tavolinat, terasat, tendat, gjeneratorët statik, pajisje për shitje të akulloreve dhe të ngjashme).

Neni 88

- 88.1 Kërkesës për vendosjen e objekteve të përkohshme të lartshënuara duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente:
- 88.1.1 Kopja e letërnjoftimit,
 - 88.1.2 Certifikata e biznesit, etj.,
 - 88.1.3 Pëlqimi mbi kushtet higjieno-sanitare nga inspekcioni sanitar (për shitje të akulloreve),
 - 88.1.4 Pëlqimin ose kontratën me mbi 50% të pronarëve, ku përcaktohen obligimet e shfrytëzuesit të hapësirës ndaj pronarëve. (hapsirat e brendëshme)
- 88.2 Hapësirat e jashtme të objekteve të banimit në bashkëpronësi, pavarësisht pronësisë (publike apo private), kushdo që i shfrytëzon këto hapësira për qëllime biznesi dhe qëllime tjera duhet të pajiset me leje nga organet kompetente komunale –DUPH.

Ndalesat

Neni 89

- 89.1 Në hapësirat publike për objektet e përkohshme ndalohej:
- 89.1.1 Lënia e objektit të përkohshëm (reklamës, tezgës dhe çfarëdo objekti tjetër) që nuk është funksional, i braktisur ose i dëmtuar,
 - 89.1.2 Vendosja e objekteve të përkohshme pa leje përkatëse nga DUPH-ja,
 - 89.1.3 Vendosja e objekteve të përkohshme pa lejen e DUPH-së ose personit juridik/fizik të kontraktuar nga Komuna,
 - 89.1.4 Vendosja e objekteve të përkohshme në hapësirat ku pengojnë dukshmërinë e qarkullimit të trafikut,
 - 89.1.5 Punë të tjera që sjellin papastërti dhe dëmtim të hapësirës publike,
 - 89.1.6 Reklamimi dhe promovimi i produkteve të duhanit, pijeve alkoolike, substancave narkotike dhe produkteve të tjera të ngjashme.

Ndërtesat dhe pamja e tyre e jashtme

Neni 90

Pronarët e ndërtesave, shfrytëzuesit e ndërtesave janë të obliguar që personalisht, ose me anë të ndërmarrjes së autorizuar për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të higjienës, të ndërmarrin masa gjegjëse lidhur me pastrimin e hapësirave të përbashkëta banesore.

Neni 91

Nëse në ndërtesë për shkak të prishjes së kanalizimit derdhen ujërat e zeza dhe ujërat fundrrinore në lokalet e përbashkëta e të ngjashme, shfrytëzuesit - pronarët e lokaleve apo ndërtesave, janë të

obliguar që me shpenzimet e veta t'i evitojnë prishjet në rrjetin e kanalizimit e të ujësjellësit.

Neni 92

- 92.1 Pamja e jashtme e ndërtesës (fasada, ballkoni, dyert, dritaret etj., pa marrë parasysh destinimin e tyre, shfrytëzimin apo pronësinë), pa tjetër duhet të mirëmbahet në pajtim me kërkesat estetike dhe pamjen e ndërtesës, ndërsa kushtet do t'i përcaktojë Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.
- 92.2 Pronarët e njësive banesore (ndërtesave) dhe shfrytëzuesit, janë të obliguar t'i mirëmbajnë fasadat dhe detajet e fasadave (ballkonet, tarracat, zdrukthëtaritë, ulluqet, tabelat dhe numrat e shtëpive e të ngjashme), ngjyrosjen, emalimin, në mënyrë që gjithmonë të jenë në gjendje të rregullt dhe ta kenë pamjen estetike.
- 92.3 Për pastërtinë dhe rregullimin e objektit, nga paragrafi paraprak, janë të obliguar të kujdesen shfrytëzuesit e banesave dhe shfrytëzuesit e tjerë të hapësirave, në pajtim me dispozitat e rendit shtëpiak dhe të ndërtesave banesore, ndërsa për rregullimin dhe pastërtinë e pjesëve të jashtme të ndërtesave tjera, do të kujdesen shfrytëzuesit e hapësirave në ato ndërtesa ose ndërmarrja e cila drejton ndërtesën dhe pronarët e ndërtesës.

Neni 93

- 93.1 Oborret e njësive banesore dhe të lokaleve, duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të rregullt.
- 93.2 Për pastrimin e oborreve të ndërtesave të banimit e të punës, kujdesen personat që i shfrytëzojnë ndërtesat e punës dhe Këshilli i banuesve, ndërsa për pastrimin e oborreve rreth ndërtesave të banimit dhe hapësirave të punës, kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave.

Neni 94

Pronarët e njësive banesore, respektivisht shfrytëzuesit e sipërfaqeve të pandërtuara dhe qiraxhinjtë e hapësirave afariste, janë të obliguar t'i pastrojnë ndërtesat dhe sipërfaqet rreth ndërtesave, respektivisht të sipërfaqet e pandërtuara të cilat i shfrytëzojnë ata.

Neni 95

- 95.1 Ndalohet hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta: korridore, shkallë, ashensorë etj.
- 95.2 Ndalohet lëshimi i ujit dhe të ngjashme për larjen e ballkoneve, me qëllim të mospengimit të fqinjët apo të tjerëve.
- 95.3 Ndalohet liriimi i tymit, blozës, avullit, kundërmimit të rëndë, gazrave toksike etj, nga ndërtesat, lokalet e punës, tymtarët, gjeneratorët etj. në afërsi të ndërtesave shumëkatëshe të banimit dhe atyre afariste, veçanërisht në afërsi të ballkoneve, fasadave, dritareve, tarracave dhe hyrjeve në korridore e në shkallë.
- 95.4 Ndalohet varja e vazove të luleve në pjesën e jashtme të balkoneve, terasave, dritareve në objektet me etazhitet të lartë.

Neni 96

- 96.1 Organi i Administratës për punët e inspektimit, me vendim mund t'i urdhërojë personat përgjegjës për mirëmbajtjen e pastërtisë dhe të rregullsisë së pjesëve të ndërtesave, që t'i eliminojnë mangësitë menjëherë apo në afat të caktuar.

- 96.2 Nëse obliguesi nuk vepron sipas vendimit, ndaj tij ushtrohet kërkesë kundërvajtëse dhe masa tjera ligjore.

Neni 97

- 97.1 Ndërtesat dhe objektet tjera, të cilat nuk mund të shërbejnë për destinimin e paraparë dhe japin një pamje jo të mirë, për shkak se janë vjetruar dhe mund të rrezikojnë ose paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, për trafik ose objektet fqinje, duhet të rrënohen ose të mënjanojnë.
- 97.2 Vendimin për rrënim, respektivisht mënjanim, e merr inspektori komunal për punët e ndërtimit sipas ligjeve dhe akteve tjera nënligjore në fuqi.

Vitrinat

Neni 98

Të gjithë shfrytëzuesit e objekteve të sapondërtuara afariste ose të ndërtesave banesore me hapësira afariste, të cilat janë paraparë për shfrytëzim për nevojat vetjake ose për dhënien e tyre me qira, janë të obliguar që vitrinat, para fillimit të përdorimit, të bëhen ashtu si parashihet me projektin e ndërtesës.

Neni 99

- 99.1 Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste në qytet dhe në paralagjet e qytetit, janë të obliguar që vitrinat t'i rregullojnë në mënyrë estetike dhe profesionale.
- 99.2 Lëndët të cilat shërbejnë për ekspozim, duhet të jenë të pastra dhe të pa dëmtuara dhe çmimet e shkruara me material të njëjtë në të gjithë artikujt.
- 99.3 Nëpër vitrina mund të vendosen reklamat e prodhimeve dhe shërbimet e shfrytëzuesve, ose të ndërmarrjeve me të cilët shfrytëzuesi është në lidhje afariste, Shfrytëzuesit e të gjitha hapësirave afariste dhe pronarët e tyre, janë të obliguar të vendosin orarin e punës.
- 99.4 Mbishkrimi vendoset në derën hyrëse të hapësirës afariste, shitores-lokalit, në pjesën e brendshme.

Neni 100

- 100.1 Shfrytëzuesit janë të obliguar t'i mbajnë pastër dhe në gjendje të rregullt vitrinat e hapësirave afariste.
- 100.2 Në rast të zhvillimit të punëve në adaptimin, rikonstruktimin, regjistrimin e të ngjashme, vitrinat duhet të jenë të mbuluara në mënyrën më të përshtatshme nga shikimi i kalimtarëve.

Neni 101

- 101.1 Pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e ndërtesave afariste dhe të hapësirave afariste në qytet dhe në paralagje të qytetit, janë të obliguar t'i adaptojnë vitrinat e vjetruara, të cilat e shëmtojnë pamjen e ndërtesës.
- 101.2 Inspekcioni komunal kompetent vërteton vjetërsinë e vitrinës dhe përcakton mënyrën e adaptimit të hapësirës afariste nga paragrafi paraprak, respektivisht e obligon shfrytëzuesin e hapësirës në lidhje me adaptimin e vitrinës.
- 101.3 Lejen për adaptimin e vitrines, zgarës etj..., e lëshon Drejtoria e Urbanizmit.
- 101.4 Vitrinat, zgarat etj. të nxjerra jashtë murit të lokalit dhe në trotuar të cilat i pengojnë kalimtarët, duhet të tërhiqen në afat prej 1 muaji, nga dita e miratimit të kësaj Rregulloreje. Pas kalimit të këtij afati, inspektori jep urdhër me shkrim për largim. Nëse prapë nuk bëhet largimi, atëherë nxjerr aktvendim për mbylljen e lokalit dhe me shpenzime të pronarit, angazhon ndërmarrjen përkatëse për largimin e pengesës në

trotuar - rrugë.

Rrethojat

Neni 102

- 102.1 Të gjitha rrethojat në sipërfaqe publike, pa marrë parasysh pronësinë, mund të ndërtohen vetëm në bazë të lejes paraprake të organit kompetent komunal për Urbanizëm- DUPH .
- 102.2 Të gjitha llojet e rrethojave duhet të ndërtohen në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Neni 103

- 103.1 Pronarët e rrethojave të vjetra, janë të detyruar t'i mënjanojnë ato në afatin prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, dhe në vend të tyre të vendosin rrethojat e tipit të caktuar, sipas lejes të organit të Administratës komunale.
- 103.2 Nëse ndërtimi i paraparë i rrethojës së tipizuar kërkon mjete më të mëdha materiale, organi i Administratës kompetente për urbanizëm, mundet përkohësisht të lejojë që në vend të rrethojës së tipizuar, të vihen rrethojat prej druri të gjelbër, por ato duhet të mirëmbahen deri në vendosjen e tipit gjegjës të rrethojës.
- 103.3 Të gjitha rrethojat, duke i përfshirë edhe rrethojat e gjelbra, duhet të mirëmbahen në gjendjen e paraparë, në mënyrë që të mos prishet pamja e përgjithshme e asaj pjese të qytetit.

Neni 104

Rrethojat e gjelbra duhet të mirëmbahen, në mënyrë që të mos kalojnë vijën rregullative dhe të mos pengojnë trafikun publik. Deri të kryhet forma përfundimtare e rrethojës së gjelbër, si mbrojtëse mund të shfrytëzohet rrethoja ekzistuese.

Gropat dhe pusetat në rrugë

Neni 105

- 105.1 Për sigurimin e kalimtarëve dhe të trafikut:
 - 105.1.1 të gjitha gropat dhe pusetat e të ngjashme, në rrugë, sheshe, oborre, bodrume, korridore dhe në vendet e ngjashme, duhet të jenë të mbyllura;
 - 105.1.2 pusetat për ujësjellës dhe kanalizim, për kabllot elektrike dhe të telefonisë e të ngjashme, duhet të ndërtohen dhe të mbahen në gjendje të rregullt.
- 105.2 Për mirëmbajtjen e gropave, pusetave etj. nga paragrafi paraprak, pika **a**, janë të obliguar që të kujdesen pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e pasurive të paluajtshme të cilëve iu shërbejnë, ndërsa për gropat nga pika **b** e këtij neni, janë të obliguara të kujdesen ndërmarrjet të cilat e ushtrojnë atë veprimtari.

Neni 106

- 106.1 Gropat dhe pusetat e të ngjashme të përfshira në këtë Rregullore, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të mbahen të mbyllura me mbulesë adekuate të sigurt sipas normave dhe standardeve ndertimore në fuqi.
- 106.2 Gjatë kohës së përdorimit, gropat patjetër duhet të rrethohen dhe të shënohen me shenjë që shihet mirë dhe sipas nevojës, të mbyllën mirë, në mënyrë që të mos e pengojnë

sigurimin e kalimtarëve ose të trafikut.

Terrenet sportive

Neni 107

Terrenet dhe fushat e sportit janë sipërfaqe të lira publike, ku mbahen manifestime sportive me qëllim të organizimit të garave dhe të argëtimit.

Neni 108

Terrenet sportive dhe objektet sportive, nuk mund të shfrytëzohen pa lejen paraprake të titullarit.

Neni 109

109.1 Ndalohet:

- 109.1.1 kapërcimi i rrethojave të terreneve sportive dhe të qendrave sportive rekreative;
- 109.1.2 hipja ose mbështetja në rrethojat e terreneve sportive dhe të qendrave sportive dhe rekreative;
- 109.1.3 kullotja e bagëtisë në terrenet sportive dhe rekreative;
- 109.1.4 të gjitha veprimet tjera me të cilat dëmtohen terrenet sportive dhe qendrat sportive rekreative.

Neni 110

- 110.1 Terrenet për sport dhe argëtim (stadiumet, qendrat sportive-rekreative, fushat e sportit dhe hapësirat e objekteve të ngjashme), duhet të mirëmbahen dhe të pastrohen rregullisht, për të cilat kujdesen organet, personat juridikë dhe fizik, të cilët këto objekte i shfrytëzojnë dhe i mirëmbajnë.
- 110.2 Në hapësirat dhe objektet nga paragrafi paraprak, duhet të vendosen në vend të dukshëm, në formë të shkruar, udhëzimet higjienike dhe teknike për punë në këto hapësira dhe terrene.
- 110.3 Vizitorët janë të obliguar që t'u përmbahen udhëzimeve dhe dispozitave nga paragrafi paraprak.

Shënimi i rrugëve dhe i ndërtesave

Neni 111

- 111.1 Të gjitha rrugët duhet të kenë të shënuar, në këndet e tyre, tabelat me emërtimin e rrugëve, ndërsa ndërtesat dhe shtëpitë duhet të kenë numrat e tyre.
- 111.2 Shënimet me emërtimin e rrugëve dhe të shesheve, si dhe shënimet e ndërtesave dhe të trojeve, bëhen nga ana e organit kompetent.
- 111.3 Komuna i mbulon shpenzimet e punimit dhe të vendosjes së tabelave me mbishkrimet e rrugëve dhe numrave të objekteve.

Neni 112

Organi i Administratës kompetente komunale mban evidencën për rrugët, emërtimin e tyre dhe numrat e shtëpive, dhe kryen me kohë ndërrimin e evidencave të nevojshme.

Neni 113

Drejtoria e Shërbimeve Publike përcakton formën, madhësinë dhe ngjyrën e tabelave për shënimin dhe emërtimin e rrugëve dhe të shesheve, të tabelave me numër të shtëpive, mënyrën e shënimit dhe afatin e vendosjes së tyre. Drejtoria për këtë mban evidencën në pajtim me nenin paraprak.

Objektet publike dhe higjienike

Neni 114

Të gjitha ndërtesat, objektet hoteliere (hotelet, motelet, autokampet) objektet për mbarëvajtjen e shfaqjeve, ligjëratave, hapësirat e klubeve, stacionet e autobusëve, stacionet hekurudhore dhe objektet tjera të ngjashme, patjetër duhet të kenë të ndërtuara më shumë nyje sanitare, në pajtim me dispozitat dhe kushtet higjieno - teknike.

Neni 115

- 115.1 Nyjat sanitare në ndërtesat e kinemave, teatrove, lokaleve të klubeve, stacioneve hekurudhore, objektet hoteliere, punëtori me prodhime jetësore-ushqimore, terrene sportive dhe nyjat sanitare në vendet tjera publike, duhet të jenë të gëlqerosura dhe këtë duhet bërë çdo 30 ditë, nëse nuk janë të ngjyrosura me ngjyra të yndyrshme ose nuk janë me pllaka qeramike ose prej materialit të ngjashëm.
- 115.2 Dezinfektimi i nyjave sanitare në objektet hoteliere, kinema, spitale, shkolla dhe i nyjeve sanitare publike, bëhet për çdo ditë.
- 115.3 Gjatë sezonit të verës nyjat sanitare sipas paragrafit paraprak, duhet të spërkaten me mjete dezinfektuese çdo 7 ditë.

Neni 116

- 116.1 Gropat septike duhet të gjenden jashtë ndërtesave dhe duhet të jenë të larguara së paku 2 m nga muri i jashtëm i ndërtesës dhe ndërtesës fqinje.
- 116.2 Gropat septike mund të ndërtohen nga çimentoja, guri ose tullat, dhe patjetër duhet të jenë të lyera me llaç çimentoje dhe të izoluara.
- 116.3 Gropat pa tjetër duhet të jenë të mbyllura hermetikisht, me pllakë betoni, guri ose metali.
- 116.4 Gropat septike nuk mund të ndërtohen në trotuare dhe në sipërfaqe tjera publike.
- 116.5 Lejen për ndërtim e jep DUPH - ja, në bazë të pëlqimit të inspektorit sanitar.

Neni 117

Organi i Administratës për punët e inspektimit, mund të caktojë me vendim mënjanimin e nyjës sanitare dhe të gropës septike dhe të japë urdhër që të ndërtohet e reja, nëse ajo nuk është ndërtuar sipas kushteve të parapara me dispozitat e kësaj Rregulloreje, sepse mund të paraqesë rrezik për rrethinën në pikëpamje shëndetësore- higjienike.

Gropimi i sipërfaqeve publike

Neni 118

- 118.1 Ndalohej çdo gropim dhe çdo dëmtim në sipërfaqeve publike, me përjashtim të rasteve të parapara me këtë Rregullore.
- 118.2 Qytetarët dhe personat fizikë – juridikë, nuk mund të bëjnë gropim e sipërfaqeve publike.
- 118.3 Sipërfaqet mund të gropohen në bazë të lejes së organit kompetent administrativ, me rastin e vendosjes së rrjetit të ri të ujësjellësit, të kanalizimit, të rrjetit telefonik, të objekteve të sinjalizimit në trafik, pastaj lidhur me ndërlidhjen e ndërtesave dhe objekteve të tjera për këto rrjete, si dhe për mirëmbajtjen e instalimeve të këtyre objekteve (në tekstin e mëtejme pajisjet komunale).

Neni 119

- 119.1 Sipërfaqet publike, me lejen e organit kompetent, mund të gropohen edhe për vendosjen e objekteve të përhershme ose të përkohshme, siç janë: shtyllat, panot, reklamat, tabelat e shpalljeve e të ngjashme.
- 119.2 Objektet nga paragrafi paraprak, mund të mbesin edhe pas skadimit të afatit për të cilin janë vendosur, nëse ato shërbejnë për zbulimin e qytetit dhe nëse merret leja nga organi kompetent i Administratës komunale.

Neni 120

Sipërfaqet e grupuara publike menjëherë duhet të merremtohen dhe të kthehen në gjendjen e mëparshme.

Neni 121

- 121.1 Evitimi i prishjeve në pajisjet komunale dhe gropimi i sipërfaqeve publike, mund të bëhen nga ana e ndërmarrjeve të cilat kujdesen për këto pajisje. Rastet kur ndodhin prishjet urgjentisht duhet të evitohen.
- 121.2 Në raste të tilla, ndërmarrja e cila e ka bërë gropimin është e obliguar që në ditën vijuese, ta njoftojë organin komunal kompetent për gropimin e sipërfaqes publike dhe njëkohësisht të kërkojë lejen për gropim.
- 121.3 Nëse organi kompetent vlerëson se evitimi i prishjes, nga paragrafi 122.1 i këtij neni, nuk ka qenë i natyrës urgjente, konsiderohet se punët e kryera janë bërë pa leje dhe kryesi i punëve i bartë të gjitha pasojat juridike ligjore.

Neni 122

Gropimin e sipërfaqeve publike, në perimetër prej 1m për nderrimin e objekteve nga neni 19 i kësaj Rregulloreje, mund ta bëjë edhe ndërmarrja që i vendos ato objekte, ndërsa merremtimin kryen vet ose nga ndërmarrja për mirëmbajtjen e objekteve komunale.

Neni 123

- 123.1 Kërkesa për dhënien e lejes për gropimin e sipërfaqeve publike, duhet t'i përmbajë shënimet mbi llojin dhe sipërfaqen e bazës (shtresës), e cila duhet të gropohet, qëllimin e ropimit dhe vendin e saktë ku do të bëhet gropimi, koha, fillimi dhe përfundimi i punëve etj.
- 123.2 Kërkesës duhet bashkëngjitur edhe situata (skica) e terrenit, me terrenin e vizatuar dhe sipërfaqen për gropim, dhe me pozitën e pajisjeve komunale në krahasim me pikat

e shenjuara (të pashme), si dhe thellësinë e gropimit.

Neni 124

- 124.1 Lejen për gropimin e sipërfaqeve publike e jep organi kompetent për punë komunale-DUPH.
- 124.2 Në vendimin për lejimin e gropimit, pa tjetër duhet të shënohet koha e fillimit të gropimit he e përfundimit të punëve në meremetimin e sipërfaqeve të grupuara.
- 124.3 Nëse punët nuk mund të kryhen në afatin e caktuar për shkak të gropimit të sipërfaqes publike, investuesi është i obliguar që të kërkojë nga organi kompetent vazhdimin e punimeve.

Neni 125

- 125.1 Gjatë gropimit të sipërfaqeve publike, patjetër duhet të sigurohet vendi I paraparë për ndërtim, në mënyrë të theksuar me shenja, rrethojë dhe masa tjera mbrojtëse, në pajtim me dispozitat mbrojtëse në ndërtimtari.
- 125.2 Kryesi i punëve veçanërisht është i obliguar që:
 - 125.2.1 gropimin ta kryejë sipas lejes së dhënë;
 - 125.2.2 vendi i paraparë për ndërtim të jetë i ndriçuar gjatë natës;
 - 125.2.3 vendin për ndërtim ta rregullojë në mënyrë që të mundësohet qarkullimi i automjeteve dhe i këmbësorëve pa pengesë;
 - 125.2.4 të shënohet dhe gjatë natës të ndriçohet vendi ku është lejuar, respektivisht ndaluar kalimi i automjeteve dhe këmbësorëve;
 - 125.2.5 punët të kryhen në pajtim me të gjitha kushtet teknike, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve dhe të shesheve

Neni 126

- 126.1 Baza e grupuar (sipërfaqja) duhet të kthehet në gjendje të mëparshme, në mënyrën dhe afatin që është caktuar në aktvendimin e lejes për gropim.
- 126.2 Sipërfaqja e ndërtuar publike, nuk guxon të shfrytëzohet pa lejen e organit kompetent.

Neni 127

Nëse bëhet gropimi i trotuarit, kryesi i punëve është i obliguar që me mjete përkatëse, të sigurojë kalimin mbi pjesën e grupuar të rrugës.

Neni 128

Kryesi i punëve është i obliguar që të sigurojë qasje pa pengesë në ndërtesat afariste dhe në lokale, si dhe në ndërtesat banesore e objektet tjera.

Neni 129

- 129.1 Gjatë ndërtimit të rrugëve të reja ose rikonstruktimit të rrugëve ekzistuese, ndërmarrjet për mirëmbajtjen dhe qeverisjen e pajisjeve komunale, si dhe qytetarët dhe ndermarjet, të cilat në ato rrugë posedojnë objekte, duhet të jenë të njoftuara së paku 2 muaj para fillimit të ndërtimit ose rikonstruktimit, në mënyrë që të përgatitet për vendosjen e pajisjeve komunale ose për lidhjen e objekteve të veta me këto pajisje.

- 129.2 Qytetarët dhe subjektet tjera me të cilat kanë të bëjnë dispozitat e paragrafit paraprak, janë të obliguar që mbi nevojat e kryerjes së punëve në pajisjet komunale dhe në lidhjet, të njëjtit ta njoftojnë investitorin i cili punon ose rikonstrukton rrugën, në mënyrë që vendosja e lidhjeve të bëhet para ndërtimit ose rikonstruktimit të rrugës.
- 129.3 Rrugët e projektuara dhe të rikonstruktuar, nuk mund të gropohen para 3 vjetëve nga mbarimi i ndërtimit ose rikonstruktimit, përveç në raste të parapara me këtë Rregullore.

Neni 130

- 130.1 Investuesi është i obliguar që, para marrjes së lejes për rikonstruktimin e sipërfaqeve publike, ta deponojë depozitën bankare, në pajtim me rregullat e prokurimit, për evitimin e lëshimeve eventuale dhe meremetimin e sipërfaqeve publike.
- 130.2 Para marrjes së lejes për rikonstruktimin e sipërfaqeve publike, investuesi është i obliguar që të sigurojë nga kryesi i punës, garancinë për cilësinë e punëve të kryera.

Neni 131

- 131.1 Nëse paraqiten dëmtime në afatin garantues prej 1 viti nga dita e kryerjes së punimeve në sipërfaqet e grupuara, meremetimin e bart investitori me shpenzimet e veta.
- 131.2 Nëse investitori nuk i kryen meremetimet në bazë të paragrafit paraprak, ato i kryen organi kompetent i administratës, por në barrën e tij.

Pastrimi i qytetit

Neni 132

Në interes të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurimit të kushteve higjienike në qytet dhe në paralagjet, rrugët, parqet, çerdhet e fëmijëve, oborret e ndërtesave familjare dhe afariste, trojet e lira dhe sipërfaqet tjera të hapura dhe të gjitha hapësirat e përbashkëta, duhet patjetër të mirëmbahen në gjendje të pastër sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 133

Për mirëmbajtjen e pastërtisë janë të obliguar të kujdesen qytetarët, ndërmarrjet, institucionet, organizatat, etj.

Neni 134

Mbajtja e pastërtisë në kuptim të dispozitave të kësaj Rregulloreje, parashihet për:

- rrugët, trotualet dhe sheshet,
- parqet,
- shëtitoret, terrenet sportive dhe argëtuese,
- stacionet e autobusëve dhe vendqëndrimet e autobusëve në vijat urbane dhe ndërrurbane,
- ambulancat, spitalet, çerdhet e fëmijëve dhe institucionet tjera,
- stacionet hekurudhore,
- stacionet e karburanteve,
- varrezat,
- tregjet,
- shtrati i lumit,
- hapësirat e hapura dhe të zbrazëta ndërmjet banesave dhe rreth tyre, si dhe toka ndërtimore e pandërtuar (trojet e zbrazëta).

Neni 135

- 135.1 Për mbajtjen e pastërtisë në stacionet e autobusëve, të karburanteve dhe në objektet hoteliere, autokampet dhe në vendet e ngjashme, janë përgjegjëse ndërmarrjet punuese dhe subjektet, të cilat e kanë të drejtën e shfrytëzimit të këtyre objekteve.
- 135.2 Shfrytëzuesit nga paragrafi 135.1 i kësaj Rregulloreje, janë të obliguar që në peronat, sallat e pritjes dhe në vendet tjera ku frekuentojnë njerëzit, në vendet e përshtatshme, të vendosin numër të mjaftueshëm të shportave për hedhjen e mbeturinave.
- 135.3 Nyjat sanitare publike duhet mbajtur në gjendje të rregullt dhe të jenë të pajisura me mjete të nevojshme, si dhe të dezinfektohen kohë pas kohe me mjete përkatëse. Nyjat sanitare publike pa tjetër duhet të jenë të hapura çdo ditë, prej orës 05:00 deri në ora 24:00.

Neni 136

- 136.1 Për mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqe publike, janë të obliguar të kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e këtyre sipërfaqeve
- 136.2 Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike, punët mund t'ia besojnë ndërmarrjes së specializuar për mbajtjen e pastërtisë.

Neni 137

- 137.1 Pronarët dhe shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike, janë të obliguar që ta mbajnë pastërtinë në nivel të kënaqshëm.
- 137.2 Pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore, të hapësirave afariste dhe trojeve të zbrazëta, janë të obliguar t'i pastrojnë trotualet dhe sipërfaqet e tyre rreth ndërtesave, para trojeve.
- 137.3 Organi i administratës kompetent për punë komunale, para dhënies së lejes për shfrytëzimin e sipërfaqeve të lira publike (cirqeve, organizatave të ndryshme), do të sigurojë dëshminë mbi taksën e paguar.

Neni 138

Të gjitha oborret dhe korridoret e ndërtesave banesore, duhet të jenë në gjendje të rregullt dhe të pastër. Për mirëmbajtjen e oborreve dhe korridoreve të ndërtesave banesore kujdesen pronarët, respektivisht shfrytëzuesit e atyre oborreve, korridoreve dhe bodrumeve

Neni 139

- 139.1 Shfrytëzuesit e hapësirave afariste janë të obliguar që:
 - 139.1.1 xhamat në dritare dhe vitrina t'i kenë gjithmonë të pastërt dhe të rregullt;
 - 139.1.2 të mirëmbajnë pastërtinë e trotuarit prej lokalit deri te rruga për komunikacion;
 - 139.1.3 të largojnë borën dhe akullin nga trotuari gjatë sezonit të dimrit.

Neni 140

- 140.1 Të gjithë banorët e qytetit, paralagjeve dhe fshatrave janë të obliguar që të kujdesen për mbajtjen e pastërtisë në vendet publike dhe sipërfaqet tjera.
- 140.2 Të gjithë banorët e qytetit, paralagjeve dhe fshatrave janë të obliguar t'i pastrojnë trotualet, respektivisht pjesët e rrugëve para shtëpive të tyre, oborret dhe sipërfaqet tjera

përpara dhe rreth shtëpive.

140.2.1 Ndalohet:

- 140.2.1.1 hedhja e mbeturinave, plehut të kafshëve dhe materialit tjetër fundërrinor në shtretërit e përrenjve, në rrugë dhe në sipërfaqe tjera publike;
- 140.2.1.2 hedhja e plehut të kafshëve në sipërfaqet publike dhe jashtë oborreve të tyre;
- 140.2.1.3 mbajtja e sasisë së madhe të plehut të kafshëve në oborre;
- 140.2.1.4 dalja në rrugë e kanaleve përcjellëse të ujit fundërrinor dhe të fekaleve, në sipërfaqe të lira publike dhe në oborret e huaja
- 140.2.1.5 mbyllja e kanaleve përcjellëse nëpër rrugët e rendit të katërt dhe dëmtimet e ndryshme të këtyre pajisjeve;
- 140.2.1.6 hedhja dhe mbulimi i kafshëve dhe shpezëve të ngordhura jashtë varrezave të destinuara për kafshë;

Neni 141

- 141.1 Fshirja dhe larja e rrugëve duhet të bëhet sipas mënyrës që siguron efektin më të mirë të pastrimit dhe duke mos penguar qarkullimin e qytetarëve dhe zhvillimin normal të trafikut.
- 141.2 Ndalohet larja e rrugëve gjatë periudhës kohore 07:00 - 23:00, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 142

- 142.1 Të gjitha automjetet tjera tërheqëse para se të hyjnë në sipërfaqet publike të trafikut publik, patjetër duhet të pastrohen nga balta dhe mbeturinat tjera.
- 142.2 Të gjitha mjetet bartëse para daljes në trafik publik, patjetër duhet të pastrohen nga balta dhe papastërtia e shkaktuar nga shkarkimet gjatë punës në objektet ndërtimore dhe nga hapësirat tjera, nga të cilat balta dhe papastërtitë tjera mund të barten në sipërfaqe publike.

Neni 143

- 143.1 Mjetet (qerret) tërheqëse mund të qëndrojnë vetëm në vendin e caktuar për atë qëllim nga ndërmarrja publike që kujdeset për pastërtinë e qytetit, në bashkëpunim me organet komunale.
- 143.2 Për mbajtjen e pastërtisë në vendet sipas paragrafit paraprak, pronarët e mjeteve tërheqëse ia paguajnë kompensimin ndërmarrjes që kujdeset për mbajtjen e pastërtisë në këto vende.

Neni 144

- 144.1 Me qëllim të mbajtjes sa më të mirë të pastërtisë në sipërfaqe publike, vendoset numër i mjaftueshëm i shportave të mbeturinave.
- 144.2 Për vendosjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e shportave, kujdeset ndërmarrja për mirëmbajtjen e higjienës publike.
- 144.3 Mënyrën vendin dhe numrin e kontejnerëve dhe të mjeteve tjera në sipërfaqe tjera publike, e cakton organi përkatës i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në bashkëpunim me kompaninë e caktuar për mirëmbajtje dhe pastrim.

Neni 145

Bartja e mbeturinave bëhet gjatë ditës dhe gjatë natës. Gjatë bartjes së mbeturinave mjetet me të cilat ato barten, patjetër duhet të jenë të mbyllura ose të mbuluara, në mënyrë që të pengohet derdhja e tyre gjatë transportit deri në deponinë e caktuar.

Neni 146

- 146.1 Mbledhja e mbeturinave nga hapësirat banesore e afariste, bëhet me anë të enëve speciale.
- 146.2 Vendi dhe mënyra e vendosjes së enëve speciale caktohet nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike në bashkëpunim me kompaninë e caktuar për mirëmbajtje dhe pastrim.

Neni 147

- 147.1 Ndërmarrja dhe qytetarët, me shpenzimet e veta, janë të obliguar të sigurojnë numër përkatës të mjeteve, enëve speciale për mbledhjen e mbeturinave nga hapësira e tyre punuese dhe sipërfaqet e lira.
- 147.2 Sigurimin e enëve-mjeteve speciale të parapara me këtë Rregullore, obliguesit janë të detyruar që ta bëjnë në afat prej 1 muaji nga dita e hyrjes së saj në fuqi.

Neni 148

- 148.1 Mbeturinat dhe fundërrinat transportohen dhe groposen në vendin e paraparë për këtë destinim (depo), ndërsa fekalet transportohen në inplantin e trajtimit të ujërave të zeza.
- 148.2 Deponimin dhe vendin e derdhjes së fekaleve e cakton Drejtoria e Shërbimeve Publike, me mendimin paraprak nga Inspektorati kompetent komunal.
- 148.3 Për rregullimin e depos, të vendit për derdhjen e fekaleve dhe mirëmbajtjen e tyre, kujdeset ndërmarrja së cilës i besohen punët e pastrimit të qytetit.
- 148.4 Vendet në të cilat vendosen fekalet, patjetër duhet të jenë të rregulluara në atë mënyrë që fekalet të mos derdhen dhe të mos shpërndahen nga era.

Neni 149

- 149.1 Bartjen e mbeturinave nga enët e caktuara për mbeturina (enët speciale dhe kontejnerët), e kryen ndërmarrja së cilës i besohen punët e pastrimit.
- 149.2 Ndërmarrja së cilës i janë besuar punët për mirëmbajtjen e higjienës së qytetit, është e obliguar t'i përmbahet planprogramit të miratuar për pastrimin e qytetit.
- 149.3 Për çdo ndryshim në lidhje me planin dhe programin e pastrimit, ndërmarrja është e obliguar që t'i lajmërojë me kohë organet gjegjëse për inspektim, respektivisht Inspekcionin komunal.
- 149.4 Tarifën për lartësinë e kompensimit për bartjen e mbeturinave e cakton Zyra e rregullatorit për ujë dhe mbeturina.

Neni 150

- 150.1 Bartja e mbeturinave nga hapësirat punonjëse, respektivisht nga hapësirat publike dhe afatet do të rregullohen me kontratë të posaçme ndërmjet ndërmarrjes së cilës i besohen punët dhe shfrytëzuesit të shërbimeve nëse nuk është vendosur ndryshe me këtë rregullore.
- 150.2 Bartja e mbeturinave nga alineja paraprake bëhet sipas nevojës të cilën e kërkon niveli i pastërtisë.

Neni 151

- 151.1 Ndërtesat duhet të kenë nyjat sanitare - higjienike. Nëse ato mungojnë në objekte, atëherë pronarët e ndërtesave janë të obliguar që, në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, t'i ndërtojnë nyjat përkatëse sanitare - higjienike.
- 151.2 Ndërtimi i nyjave sanitare higjienike dhe të gropave septike, mund të bëhet vetëm në vende të përshtatshme. Vendet ku ndërtohen ato caktohen nga ana e inspektorit dhe organit kompetent për punë komunale.

Neni 152

Heqja e fekaleve nga gropat septike, nyjat sanitare dhe të ngjashme, bëhet me anë të cisternave septike, sipas rregullit të paraparë, gjatë natës, nga ora 21:00 deri në orën 05:00 të mëngjesit.

Neni 153

- 153.1 Kryesit e punëve ndërtimore janë të obliguar të kujdesen për:
- 153.1.1 pastrimin e sipërfaqeve publike para vendeve ku ndërtohet, deri te vendi i shkarkimit të materialit;
 - 153.1.2 derdhjen e materialit shkapërderdhës dhe të pengohet pluhuri gjatë procesit të rrënimit;
 - 153.1.3 deponimin dhe sigurimin e materialit ndërtimor nga rrënimi dhe bartjen e tij nga sipërfaqja publike.

Neni 154

Personat fizikë dhe ata juridikë, të cilët bëjnë ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave ose të materialit para ndërtesave, në rrugë ose trotuare, janë të obliguar që menjëherë t'i largojnë ato dhe ta pastrojnë vendin.

Pastrimi i borës

Neni 155

- 155.1 Për pastrimin e borës nga trotuaret dhe para ndërtesave afariste dhe banesore në pronësi shoqërore, kujdesen personat juridikë, të cilët i shfrytëzojnë ndërtesat afariste dhe pleqësitë shtëpiake, ndërsa për pastrimin e borës nga trotuaret para ndërtesave familjare banesore dhe para hapësirave afariste (punëtoritë, lokalet afariste), kujdesen pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave banesore dhe të hapësirave afariste.
- 155.2 Ndërmarrjet e ndryshme dhe qytetarët, janë të obliguar që, gjatë pastrimit të sipërfaqeve nga paragrafi 156.1 i këtij neni, ta grumbullojnë borën dhe akullin në skaj të trotuarit, ndërsa ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë është e obliguar që borën e grumbulluar në skaje të trotuarit, ta bartë menjëherë jashtë qytetit, më së voni brenda 10 orësh.
- 155.3 Ndërmarrja për mbajtjen e pastërtisë, me rastin e reshjeve të mëdha atmosferike, është e obliguar që nga rrugët, trotuaret, trafiku publik dhe ai i dorës së dytë, të kujdeset dhe rregullisht t'i pastrojnë ato nga bora dhe akulli dhe të hedhin kripë në to.

Neni 156

Në rastet kur gjatë ditës bie borë, trotuaret, sipas nevojës, duhet të pastrohen edhe disa here

në ditë, dhe në rast se bora bie pandërprerë gjatë natës, ajo duhet të pastrohet në ditën e ardhshme, më së voni deri në orën 09:00 të mëngjesit.

Tregjet

Neni 157

Për mbajtjen e pastërtisë dhe higjienës komunale nëpër tregje dhe në objektet e tyre, kujdeset pronari, respektivisht shfrytëzuesi i tregjeve.

Neni 158

Tregjet duhet të mbahen në gjendje të rregullt dhe të pastër. Çdo ditë, pas mbarimit të kohës së punës, ato duhet të pastrohen mirë, të lahen dhe të kthehen në gjendje të rregullt.

Neni 159

Ndërmarrja e cila menaxhon me tregjet, është e obliguar që në të gjitha tregjet të sigurojë sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm, furnizim të rregullt për freskimin e prodhimeve dhe pastrimin e tregjeve, si dhe të ndërtojë numrin e caktuar dhe të nevojshëm të kabinave të nyjave sanitare, të cilat duhet të pastrohen dhe të mirëmbahen rregullisht, dhe të vihet numri i mjaftueshëm i enëve dhe kontejnerëve për mbeturina dhe fundërrina, të cilat duhet të pastrohen rregullisht.

Neni 160

160.1.1 Ndalohet:

160.1.1 pastrimi i tregut dhe i vendeve për shitje, gjatë kohës së zhvillimit të afarizmit në treg;

160.1.2 çdo shitje e mallit dhe e gjërave tjera ushqimore, jashtë vendit të caktuar për këtë qëllim;

160.1.3 shitja dhe ekspozimi i mallrave në vendet dhe hapësirat në afërsi të tregut, që do të pengonte qasjen dhe qarkullimin e lirë të blerësve në hapësirat para tregut dhe në hyrje të drejtpërdrejtë të tregut, të cilat në çdo kohë duhet të jenë të lira për kalimtarë, blerës dhe trafikun e automjeteve dhe të mjeteve tjera;

160.1.4 ekspozimi i mallrave në kundërshtim me kushtet e parapara në pikat 160.1.2 dhe 160.1.3 të këtij neni, dhe si pasojë bëhet konfiskimi i tyre nga ana e Inspektionit.

Neni 161

Në hapësirat e tregut ku bëhet shitja e kafshëve, duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e ujit higjienik për pije dhe ujit për kafshë, si dhe të ndërtohen nyja sanitare, me numër të caktuar të kabinave, të ndërtohen vendet për lidhjen e kafshëve dhe vendosjen e enëve për grumbullimin e mbeturinave dhe të fundërrinave. Hapësira e tregut pas çdo dite pune në treg, duhet të pastrohet mirë nga plehu dhe nga fundërrinat tjera.

Neni 162

- 163.1 Hapësira e tregut për shitjen e materialit për ngrohje (dru dhe thëngjill), produkteve tjera nga druri, shitja e gëlqeres, të prodhimeve të ngjashme, si dhe prodhimeve të tjera për të cilat është i destinuar tregu duhet të mbahet në rregull, në gjendje të pastër dhe pas çdo dite pune në treg, duhet të pastrohet pas mbarimit të orarit të punës.
- 163.2 Ndalohet shitja e prodhimeve të theksuara – materialit, jashtë hapësirës së tregut të caktuar për këto destinime.

Neni 163

163.1 Në sipërfaqe publike ndalohet:

- 163.1.1 hedhja e mbeturinave jashtë shportave dhe enëve për mbeturina, ose krijimi i papastërtisë në sipërfaqe publike në mënyra tjera;
- 163.1.2 prerja dhe copëtimi i drurëve, grimcimi i thëngjillit dhe materialit tjetër, me përjashtim në parcela të zbrazëta, nëse për këtë ekziston leja për ndërtim të ndërtesave banesore dhe të tjera;
- 163.1.3 larja e të gjitha mjeteve motorike, rrobave dhe lëndëve të tjera;
- 163.1.4 meremetimi i automjeteve dhe kryerja e veprimtarive zejtare;
- 163.1.5 lëvizja e automjeteve në të cilat është grumbulluar balta dhe papastërtia tjetër;
- 163.1.6 lëvizja e automjeteve, të cilat nuk janë siguruar nga materiali derdhës që transportohet, ose automjeteve që mundësojnë përhapjen e gazrave gjatë transportimit (fekalet) dhe materialit tjetër me erë kundërmuese, përveç lëndës së asfaltit;
- 163.1.7 lirimimi dhe shpërndarja e ujit fundërrinor dhe ndyrësirave tjera në sipërfaqe publike, në oborret fqinje dhe në korridoret e përbashkëta, ose të hidhen në ato sipërfaqe dhe të mbahen mbeturinat e të ngjashme;
- 163.1.8 mbajtja, lëvizja dhe shitja e kafshëve dhe e shpezëve;
- 163.1.9 kryerja e nevojës fiziologjike;
- 163.1.10 hapja e enëve me mbeturina (enëve dhe kontejnerëve);
- 163.1.11 prishja dhe marrja e lëndëve fundërrinore nga shportat dhe kontejnerët;
- 163.1.12 ndezja e mbeturinave nëpër enë dhe në sipërfaqe publike;
- 163.1.13 hedhja në enët për mbeturina e këtyre lëndëve: dheut, rërës, ambalazhit, mbeturinave nga kopshtet dhe mbeturina të ngjashme;
- 163.1.14 zhvendosja e dymave dhe mbulesave (kapakëve) nëpër enët për mbeturina;
- 163.1.15 zhvendosja e enëve për mbeturina nga vendet e caktuara, pa lejen e organit për punët komunale;
- 163.1.16 përdorimi i enëve për mbeturinat me vëllim mbi 120 litra;
- 163.1.17 hedhja e mbeturinave dhe e fundërrinave të tjera jashtë enëve për mbeturina;
- 163.1.18 hedhja e thëngjillit të padjegur, të hirit dhe të materialit tjetër ndezës në enët për mbeturina (kontejnerë);
- 163.1.19 lëshimi i ujit në trotuare, rrugë dhe oborre të tjerëve, nga krojet, terracat – ballkonet, pullazet dhe ulluqet;
- 163.1.20 mbajtja në gjendje jo të rregullt e hidrantëve për ujë nëpër rrugë;
- 163.1.21 ndalimi i automjeteve ose qerreve tërheqëse pranë enëve për mbeturina, kontejnerëve, sipërfaqeve të gjelbra etj;
- 163.1.22 mbajtja e automjeteve të lëna, të paregjistruara dhe të havarisura, karroseritë dhe pjesët e tyre, pajisjet, mjetet e punës, mallrat, ambalazhet dhe sendeve tjera;
- 163.1.23 vendosja e tavolinave dhe karrigeve nëpër trotuare;
- 163.1.24 mbajtja e papastërtisë në hapësirën ku bëhet pastrimi i veshmbathjeve;
- 163.1.25 mbajtja e mbeturinave dhe fundërrinave nëpër enët, të cilat nuk i plotësojnë kushtet për këtë qëllim;
- 163.1.26 shitja e prodhimeve bujqësore dhe prodhimeve tjera dhe ekspozimi i tyre në trotuare;

- 163.1.27 mbajtja e materialit ndërtimor dhe të ngjashme;
- 163.1.28 dalja me automjete të ndotura nga vendi ndërtimor dhe nga sipërfaqet tjera të ngjashme në sipërfaqe publike të trafikut public;
- 163.1.29 vendosja e gjeneratorëve statik pa leje përkatëse;
- 163.1.30 vendosja e pengesave si: barijera, kontejnerë, vazo betoni, shtylla, pengesa metalike e të ngjashme;
- 163.1.31 vendosja, ekspozimi, luajtja në instrumente muzikore të cilat lirojnë zhurmë bezdisëse për qytetarët, perpos rasteve të lejuara me këtë Rregullore apo që pajisen me leje nga organet kompetente.

Neni 164

164.1 Në të gjithë territorin e komunës rreptësisht ndalohet:

- 164.1.1 djegia e gomave, vajrave motorike, plastikës, pesticideve, barnave dhe të gjitha mbeturinave tjera toksike;
- 164.1.2 hedhja e vajrave motorike, pesticideve, barnave dhe substancave tjera toksike në sipërfaqe të tokës, në ujë dhe në kanalizim.

Neni 165

Për shërbimet të cilat i janë besuar ndërmarrjes për pastrimin e rrugëve të shtruara, largimin e borës dhe të akullit, transportimin dhe deponimin e tyre, në pajtim me këtë Rregullore, i takon kompensimi në lartësinë dhe në kushtet të cilat përcaktohen me kontratë dhe me tarifën e lejuar.

Neni 166

- 166.1 Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë, inspektori ka të drejtë të ndalë automjetin, i cili transporton mallra, material ndërtimor, material fundërrinor, dru, thëngjill etj.
- 166.2 Ndalimin e automjeteve në fjalë inspektori e bënë me paraqitjen e shenjës për komunikacion – “*ndalohet trafiku në të dy drejtimet*”, në të cilin shkruan “*STOP INSPEKTORAT*”, vozitësit e automjeteve janë të obliguar t’i ndalin automjetet në këtë rast dhe duhet t’i ofrojnë shënimet që kërkohen nga inspektorët.
- 166.3 Ndalimi i automjeteve nga paragrafi 2 i këtij neni, nuk guxon të kryhet nëpër vende ku do të shkaktohet rrezikimi i sigurisë në trafik.

Neni 167

Në Zonën Historike të Qytetit të Prizrenit vlejnë dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

III. MBIKËQYRJA

Neni 168

- 168.1 Mbikqyrjen e zbatimit dhe respektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e kryejnë organet kompetente të administratës komunale dhe inspektoratet kompetente komunale.
- 168.2 Në qoftë se Inspektoriati Komunal Kompetent për kryerjen e mbikëqyrjes ndërmerr masat ligjore administrative e cila ka për qëllim ekzekutimin e veprimit (masës), ndërsa pala nuk vepron sipas asaj mase, e njëjta masë do të zbatohet nëpërmjet personit të tretë (kompania e kontraktuar), ndërsa shpenzimet e krijuara do të bien në barrë të palës.
- 168.3 Për kthimin e objekteve dhe sendeve të konfiskuara pala obligohet ti paraqitet organit kompetent-inspeksionit kompetent komunal në afat prej 72 orësh nga ora e marrjes së objekteve dhe sendeve. Nëse palët nuk paraqiten tek organi kompetent, inspeksioni komunal në afatin e paraparë, objektet e përkohshme do t’i deponojë në objekte të

posaçme pa të drejtë kthimi apo do t'i kthehen palëve me kusht të pagesës së taksës për mbajtjen e objektit në objekte të posaçme brënda 30 ditëve.

Në raste kur brenda 72 orëve sendet respektivisht mallrat ushqimore etj..., kur mund t'iu skadojë afati i përdorimit dhe mund të prishen, komuna nuk mban përgjegjësi. Pas 30 ditësh objektet e konfiskuara do të asgjësohen

1. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 169

169.1 Ndërmarrjet e autorizuara për mbajtjen e pastërtisë, higjienës komunale dhe gjelbërimit, ndërmarrjet punuese, shkollat ose personat e tjerë juridikë, për kundërvajtje do të ndëshkohen me dënim në shumën prej 500 € deri 2000 €, nëse nuk u përmbahen dispozitave dhe masave, gjegjësisht:

- 169.1.1 nëse nuk e kryejnë pastrimin e të gjithë mbledhësve të ujit dhe të pusetave për ujin atmosferik, së paku një herë në vit (neni 5);
- 169.1.2 nëse nuk e sigurojnë për konsumatorë sasinë e mjaftueshme të ujit higjienik dhe të rregullt (neni 8);
- 169.1.3 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e parapara të nenit 11 dhe 12;
- 169.1.4 për shkak të kyçjes pa leje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit (neni 17);
- 169.1.5 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 22, 30, 33, 34, 35 dhe 36;
- 169.1.6 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 46, 47, 48, 49, 50, 52, 53, 56, 57 dhe 60;
- 169.1.7 nëse gjatë shfrytëzimit të trotuarit, rrugës dhe sipërfaqes tjetër publike vjen deri te dëmtimi i tyre (neni 61);
- 169.1.8 nëse vepron në kundërshtim me nenin 65 dhe 66;
- 169.1.9 nëse vepron në kundërshtim me nenin 69 paragrafi 69.1 dhe 69.2;
- 169.1.10 nëse kryen ndonjë veprim të ndaluar (nenin 89);
- 169.1.11 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 90, 92 dhe 93;
- 169.1.12 nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara të nenit 95 dhe 96;
- 169.1.13 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 97;
- 169.1.14 nëse nuk vepron sipas dispozitave të parapara të nenit 98;
- 169.1.15 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 99;
- 169.1.16 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 101;
- 169.1.17 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 102 dhe 103;
- 169.1.18 nëse vepron në kundërshtim me nenin 105 dhe 106;
- 169.1.19 nëse vepron në kundërshtim me ndalesat në nenin 109;
- 169.1.20 nëse vepron në kundërshtim me nenin 116 dhe 117;
- 169.1.21 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 118;
- nëse vepron në kundërshtim me nenin 120;
- 169.1.22 nëse vërtetohet nga ana e organit kompetent dhe vlerësohet se rrëmihja dhe evitimi i prishjes nga neni 121, paragrafi 3, nuk ka qenë i natyrës urgjente;
- 169.1.23 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 125;
- 169.1.24 nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara me nenet: 127, 128, 129, 130 dhe 131;
- 169.1.25 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e parapara me nenin 139;
- 169.1.26 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 140;
- 169.1.27 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 141 dhe nenit 142;
- 169.1.28 nëse vepron në kundërshtim me nenin 147, 148 dhe 149;
- 169.1.29 nëse nuk i përmbahet masave të përcaktuara në nenin 150;

- 169.1.30 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 153 dhe 154;
- 169.1.31 nëse, kur bie borë, nuk vepron në mënyrën e paraparë me nenin 156;
- 169.1.32 nëse nuk vepron sipas nenit 159, 160, 161 dhe 162;
- 169.1.33 nëse nuk vepron sipas nenit 163, 164;
- 169.1.34 për kundërvajtjet nga neni 5 deri te neni 22 dhe nenet: 30, 33, 34, 35, 46, 56, 61, 89, 95, 96, 98, 101, 121, 128, 141 dhe 156 të kësaj Rregulloreje, do të dënohen për kundërvajtje, me të holla në shumën prej 500€, edhe personi përgjegjës në ndërmarrjen e autorizuar për mirëmbajtjen e higjienës komunale dhe gjelbërimit, ndërmarrja punuese, organi shtetëror, organizatat, shkolla apo personi tjetër juridik, nëse kundërvajtja është bërë si rezultat i veprimit apo mosveprimit të tij.
- 169.1.35 nëse me rastin e paraqitjes së shenjës së komunikacionit “STOP-INSPEKTORATI”, vozitësit e automjeteve të rënda nuk i përmbahet shenjës për ndalesë dhe nuk ia ofrojnë inspektorit shënimet e kërkuara (neni 166.2).

Neni 170

- 170.1 Qytetari - personi dhe pronari i punëtorisë, i cili merret me veprimtari ekonomike ose me veprimtari zejtare, do të dënohet për kundërvajtje, me dënim në të holla në shumë prej 500 € deri 1 000 €, nëse nuk ju përmbahet masave të përcaktuara nga këto pika, gjegjësisht:
 - 170.1.1 nëse bën kyçje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit pa lejen përkatëse (neni 17);
 - 170.1.2 nëse bën ndonjërin prej veprimeve të ndaluara nga neni 36, pikat: 36.1.1, 36.1.2, 36.1.3, 36.1.4, 36.1.5, 36.1.6, 36.1.7, dhe 36.1.8;
 - 170.1.3 nëse bën ndonjërin prej veprimeve të parapara sipas nenit 53;
 - 170.1.4 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 61;
 - 170.1.5 nëse vepron në kundërshtim me nenin 62;
 - 170.1.6 nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara me nenet: 65 dhe 66;
 - 170.1.7 nëse nuk iu përmbahet masave të parapara me nenin 69, paragrafi 69.1 dhe 69.2;
 - 170.1.8 nëse vepron në kundërshtim me ndalesat e nenit 89;
 - 170.1.9 nëse nuk iu përmbahet masave të përcaktuara me nenet: nga 90, 91, 92, 93, 94;
 - 170.1.10 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 95, dhe 96;
 - 170.1.11 nëse nuk vepron në bazë të Aktvendimit të organit të Administratës-Drejtorisë së Inspekcionit, respektivisht nëse nuk i eviton mungesat në afatin e caktuar (neni 97);
 - 170.1.12 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve: 98, 99, 100 dhe 101;
 - 170.1.13 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 102;
 - 170.1.14 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 105 dhe 106;
 - 170.1.15 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 109 dhe 110;
 - 170.1.16 nëse nuk vepron në pajtim me dispozitat e nenit 116;
 - 170.1.17 nëse nuk vepron sipas nenit 117;
 - 170.1.18 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 118;
 - 170.1.19 nëse nuk vepron sipas nenit 120;
 - 170.1.20 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 126;
 - 170.1.21 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 127 dhe 128 ;
 - 170.1.22 nëse vepron në kundërshtim me nenet : 138, 139;
 - 170.1.23 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 140;
 - 170.1.24 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 142;
 - 170.1.25 nëse vepron në kundërshtim me nenin 145;
 - 170.1.26 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 150;
 - 170.1.27 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 153 dhe 154;
 - 170.1.28 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 155;
 - 170.1.29 nëse vepron në kundërshtim me nenin 157;

- 170.1.30 nëse nuk i përmbahet ndalesave të caktuara në nenin 160
- 170.1.31 nëse kryen ndonjërin prej veprimeve të ndaluara në bazë të nenit 163;
- 170.1.32 nëse vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 164;
- 170.1.33 nëse gjatë paraqitjes së shenjës së komunikacionit nga ana e inspektorit komunal "STOP-NSPEKTORATI", vozitësit e automjeteve të rënda nuk ndalen dhe nuk i ofrojnë shënimet e kërkuara nga inspektori (neni 166.2)

Neni 171

Organet kompetente – inspektoratet komunale iniciojnë procedurë kundërvajtëse në Gjykatën Kompetente për nenet 169 dhe 170.

Neni 172

- 172.1 Për kundërvajtjet e caktuara nga nenet 169 dhe 170, e në rastet e domosdoshme, inspektori komunal kompetent dhe personat me autorizime të veçanta, të cilët i autorizon Udhëheqësi i institucionit, mund të shqiptojnë dënime (gjoba mandatore) në shumën prej 100€ deri në 250 € për individët dhe personin përgjegjës, kurse personin juridik, në shumën prej 400 €.
- 172.2 Nëse personi fizik, personi juridik dhe personi përgjegjës i personit juridik brenda afatit kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh e bën pagesën e gjobës mandatore i ulet gjoba në 50%.
- 172.3 Nëse Pala nuk e paguan dënimin në afatin e caktuar nga organi kompetent komunal, mënyra e pagesës do të bëhet përmes Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 173

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Vendimi Komunal për Rregullimin e Qytetit dhe të Shërbimeve Komunale nr 01/011-2 i dt. 18.11.2004

Hyrja në fuqi

Neni 174

Kjo Rregullore hyn në fuqi pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së si dhe pas publikimit në ueb faqen elektronike të Komunës në gjuhët zyrtare dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi



SQARIM:

Rregullorja Nr.001/011-73507, për shërbime publike komunale në Komunën e Prizrenit, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, me datë 04 qershor 2024 dhe dërguar në MAPL më 07 qershor 2024, deri më datën 02 korrik 2024, nuk kemi pranuar konfirmim nëse Rregullorja është në përputhje me legjislacionin në fuqi ose jo.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Rregullores (QRK) nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të akteve të komunave dhe Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (QRK) 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, për shkak të nevojës për zbatimin e Rregullores dhe pas kalimit të afateve ligjore për shqyrtimin e ligjshmërisë nga ana e Ministrisë përgjegjëse, bëhet publikimi i Rregullores Nr.001/011-73507, për shërbime publike komunale në Komunën e Prizrenit.

Datë: 02.07.2024



**Kryesuesja e Kuvendit
Antigona Bytyqi**